



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE SHKENCAVE POLITIKE

Punimi i magjistraturës

KRIZAT PARLAMENTARE – rasti Maqedoni

Mentori:

Prof. Dr.Zemri Elezi

Kandidati:

Sebaheta Ahmed

Tetovë, 2017

Parathenia

Kapitulli i pare

I Parlamentarizmi dhe parlamenti

1. Paraqitja dhe zhvillimi i parlamentarizmit dhe sistemit parlamentar
- 1.1 Parlamenti, si institucion politik
- 1.2 Raporti reciprok i legjislativit dhe ekzekutivit
- 1.3 Kontrolli parlamentar i egzekutivit
- 1.4 Raporti i legjislativit dhe ekzekutivit si faktor i krizave parlamentare

Kapitulli i dytë

I Aspekti teorik i krizave parlamentare

1. Kuptimi i krizave parlamentare
- 1.1 Krizat parlamentare ne aspektin kushtetues
- 1.2 Krizat parlamentare në aspektin politik krizat parlamentare
2. Elementet e krizave parlamentare
- 2.1. Bllokimi ipunes se parlamentit
- 2.2 Raporti midis parlamentit dhe qeverise
- 2.3 Raportet në mes të parlamentit dhe presidentit
- 2.4 Krizat parlamentare si rezultat i veprimit opozitar

Kapitulli i tretë

I Analiza kauzale e krizave parlamentare (shkaqet dhe pasojat)

1. Krizat parlamentare- shkaqet e paraqitjes
- 1.1 Mungesa e mazhorncave stabile parlamentare
- 1.2 Konfliktet ne mes parlamenti dhe presidenti rreth zgjedhjes së Kryeministrit dhe qeverisë
- 1.3. Dështimi i koalicioneve parlamentare dhe qeveritare
- 1.4. Mosvotimi i buxhetit nga parlamenti
- 1.5 Obstruksioni parlamentar nga ana e opozitës

Kapitulli i katert

I Mënyrat e tejkalimit të krizave parlamentare

1. Shpërndarja e parlamentit
2. Koalicionet parlamentare dhe qeveritare
- 2.1 Koalicionet parazgjedhore
- 2.2 Koalicionet paszgjedhore

2.3 Koalicionet bilaterale

3. Krizat parlamentare dhe dhe opozita

3.1 Opozita si kundërpushtet

3.2. Opozita si alternative

3.3 Funksioni kontrollues i opozitës

3.4 Vështirësitë e opozitës

3.5 Opozita në shtetin demokratik

3.6 Ndarja e opozitës

Kapitulli i peste

I Krizat parlamentare në R e Maqedonisë

1. Konteksti i tranzicionit demokratik në Maqedoni
2. Ndarja dhe ballansi i legjislativit dhe egzekutivit në Maqedoni
3. Marrëdhënjet e Kuvendit me kryetarin e Republikës së Maqedonisë dhe me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë
4. Raportet mes Parlamentit dhe Qeverisë
5. Kontrolli parlamentar i qeverisë në Maqedoni
6. Skaqet dhe pasojat e krizave parlamentare në Maqedoni

II Rast studimi krizave parlamentare në Maqedoni

- P Ë R F U N D I M I
- L I T E R A T U R A

Parathënie

Jeta parlamentare si një model dominant i shprehjes së demokracisë përfaqësuese, jo rrallë karakterizohet me kriza parlamentare dhe politike. Demokracia nuk paraqet një sistem perfekt të vlerave dhe një sistem i deshirave dhe idelizmave të njëërzve. Demokracia në rradhë të parë është një proces në zhvillim permanent, i cili karakterizohet me konflikt të përhershëm të interesave në përpjekje për ndikim politik dhe rreshtim politik të akterëve të jetës politike dhe demokratike. Ky konflikt politik më së miri shprehet në jetën parlamentare, e cila ofron kushtet për ballafaqim politik të partive politike, duke krijuar mazhoranca parlamentare dhe opziten parlamentare. Në kontestin e luftës politike në jetën parlamentare fenomene tipike janë krizat parlamentare, të cilat manifestohen në kushte, forma dhe kontekste të ndryshme në vendet e ndryshme. Në faktë krizat parlamentare janë realitete politike të demokracisë parlamentare dhe pjesë e jetës demokratike të një vendi. Ato nuk mund të konsiderohen si fenomene devijante dhe negative, por si pjesë normale e një rendi demokratik ku jo rrallë paraqiten probleme politike, të cilat menaxhohen në mënyrë institucionale dhe demokratike, pa dhunë dhe pa gjak me dialog politik, kompromise dhe negociata dhe me pordorimin e mekanizmave kushtetuese dhe ligjor me të cilat restaurohet demokracia dhe evitohet qfardo përpjekje e vendosjes së diktaturës.

Fenomeni i krizave politike dhe parlamentare karakterizon edhe demokracitë e avansuare, por ai shprehet në formën më të vrazhdë në demokracitë e reja postkomuniste. Në këto vende, krahas përmbysjes së diktaturave komuniste u inagurua pluralizmi politik, i cili u manifestua me një numer të madh të partive politike dhe me krijimin e sistemeve multipartiake. Demokracia në këto vende vazhdon të jetë mjaftë e brishtë, e përcjellur me qeveri jo stabile, koalicione të dobta dhe opozitë jo aktive. Në këto shtete krizat parlamentare, kryesisht janë pasojë e veprimit opozitar dhe përpjekjeve të opozitës për të kontrolluar qeverinë dhe imponuar zgjedhje të parakohëshme.

Republika e Maqedonisë pas pavarësisë së saj ka filluar ndertimin e demokracisë parlamentare të bazuar në pluralizmin politik. Parlamentarizmi në Maqedoni ka shprehur veqoritë e tij tipike për shtetet e ish jugosllavisë, por edhe specifikat si rezultat i tensioneve ndëretnike si pasojë e pozitës së pazgjidhur kushtetuese të shqiptarëve. Në këtë kontekst në Maqedoni krizat parlamentare janë shfaqura kryesisht në procesin e formimit të qeverive dhe stabilitetit të koalicioneve parlamentare dhe qeveritare.

Nisur na kjo ,tema e propozuar është aktuale në shtetet e tranzicionit, të cilat pas përmbysjes së regjimeve totalitare dhe moniste filluan ndertimin e demokracive parlamentare. Krizat parlamentare në këto shtete janë të shpeshta, andaj studimi i kësaj teme është, jo vetëm me interes teorik, por edhe praktik dhe mund të kontribuoj në avansimin e praktikave parlamentare.

Pjesa e fundit e punimit me titull “ KRIZAT PARLAMENTARE NË REPUBLIKEN E MAQEDONISË” paraqet pjesen kryesore të punimit, analizon gjërësisht sistemin kushtetuese të Maqedonisë, përfshirë këtu edhe Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe amandamentet e saja. Në këtë kontekst përfshijë paraqitjen dhe zhvillimin e parlamentarizmit në Republikën e Maqedonisë, tiparet dalluese të shfaqjes së tij dhe aspekte tjera specifike të Maqedonisë. Me të dhëna empirike dhe paraqitje grafike analizoj përbërjen dhe strukturën e të gjitha qeverive të Maqedonisë, që nga periudhen e pavarësisë së saj, e deri me sot. Amaliza përfshinë të gjitha modelet e qeverive në periudhen e pavarësisë, përbërjen e saj, koalicionet qeveritare dhe rolin e opozitës në Maqedoni dhe të gjitha rastet e krizave parlamentare në Maqedoni, shkaqet e paraqitjes dhe mënyrat e menagjimit të tyre. Në mënyrë të veçantë studimi merret me analizen e faktorit politik shqiptarë, partitë politike shqiptare, mënyrën e organizimit dhe veprimit të tyre politik.

Në shtjellimin e kësaj tema jam përpjekur të zbatojë një metodologji tipike mër tezat e doktorrates, duke kombinuar metodat juridike, ato krahasuese, logjike, sociologjike, duke bërë përpjekje për njëkohërencë logjike të studimit. Gjithashtu jam përpjekur të shprehë qasje kritike ndaj referencave dhe citateve dhe kam shprehë mendime dhe qasje kreative dhe burimore për shumë fenomene të studijuar. Gjuha e tezes është kombinim i gjuhës ligjore dhe politike, duke bërë përpjekje për një stil të kapshëm dhe të pranushëm për opinionin e gjërë.

Për hartimin e kësaj teze kam konsultuar një literaturë të gjërë shkencore dhe profesionale, si tekste universitare, artikuj shkencor, materiale parlamentare, akte ligjore dhe kam konsultuar afër 100 kushtetuta të vendeve të ndryshme.

Në shqyrtimet përfundimtare, janë nxjerr konkluzat shkencore, të cilat i referohen propozimeve që ai jepë për shkaqet e paraqitjes dhe mënyrat e tejkalimit të krizave parlamentare

Në fund deshirojë të shprehë falenderimet antarëve të Komisionit për bashkëpunimin e suksesshëm dhe mbështetjen që më kanë ofruar në hartimin e këtij punimi.

Kapitulli i pare

I Parlamentarizmi dhe parlamenti

1.Paraqitja dhe zhvillimi i parlamentarizmit dhe sistemit parlamentar

Paraqitja dhe zhvillimi i sistemit parlamentar ishte rezultat i një periudhe të gjatë të luftës së forcave demokratike për kufizimin e pushtetit dhe apsolutizmit të monarkut apsolut dhe për fitoren e sovranitetit popullor, të shprehur në institucionet politike përfaqësuese. Parlamenti si institucion politik në kuptimin bashkëkohor është paraqitur në shekullin XVII dhe XVIII, si një nga të arriturat e revulucionit borgjez dhe si një nga bazat e demokracisë qytetare dhe të shtetit qytetar. Realizimit të qeverisjes parlamentare , i parapriu lufta e gjatë në mes të aristokracisë dhe monarkut rreth kufizimit të pushtetit apsolut dhe bartjes së disa funksioneve në organet dhe institucionet përfaqësuese¹.

Parlamenti, si institucion politik, ka lindur në Bitani të Madhe, në periudhën e kalimit nga feudalizmi në kapitalizëm, periudhë tranzicioni që nuk qe e shkurtër dhe që u karakterizua për një kohë të caktuar nga ekuilibri ndërmjet fisnikrisë feudale dhe borgjezisë qytetare të posalindur dhe që kishte tendencë rritje².

Krahas lindjes së parlamentit, janë shfaq edhe elementet e para të ekzekutivit, përkatësisht të qeverisë në kuptimin bashkëkohor. Këto embrione paraqiten dhe shprehen pas fitores definitive të regjimit parlamentar në Angli në vitin 1729. Në këtë vit përcaktohet parimi që kryeministri dhe qeveria, ndonëse kishin besimin e mbretit, duhet të përgjigjeshin edhe para parlamentit. Vetë mbretërit anglez erdhën në konkluzionin se ishte e domosdoshme që ministrat e caktuar prej tyre duhet të kishin edhe besimin e parlamentit. Në këtë kohë në praktikën kushtetuese të Anglisë (Anglia siq është e njohur nuk ka një kushtetutë të shkruar) u sanksionuan shprehimisht parimet e përgjegjësisë individuale dhe kolektive të ministrave para parlamentit, parime këto që shprefin esencën e regjimit parlamentar të qeverisjes.

¹ Prof.dr. Arsim Bajrami, Teoria dhe Praktika Parlamentare, Prishtinë 1997, fq.61

² Luan Omari, Sistemi parlamentar, Tiranë, fq.5

Pra sikur edhe vetë sistemi parlamentar, edhe qeveria e ka djepin e saj pikrisht në Angli. Me qëllim të evitimit të konflikteve me parlamentin rreth ndarjes së pushtetit, monarku ka formuar ekipin e bashkëpunorëve (këshilltarëve) të tij të cilët fillimisht mbanin përgjegjësi vetëm para monarkut, të cilit i jepnin llogari për punën e tyre. Më vonë, me qëllim të fitimit të përkrahjes së parlamentit, monarku caktonte ministrat nga rradhët e shumicës parlamentare. Nga ky moment qeveria, si organ fillon të diferencohet, sepse ministrat fillojnë të largohen nga kontrolli i drejtpërdrejtë i monarkut dhe të orientohen më tepër nga parlamenti, të cilit i paraqesin raport për punën e tyre. Kështu, qeveria, ndonëse, e zgjedhur formalisht nga mbreti lidhet organikisht me parlamentin, i cili fillon të ushtrojë kontrollin politik mbi punën e saj, duke përfshirë edhe të drejtën e shkarkimit të ministrave të caktuar apo të qeverisë si tërësi.

Më vonë me zhvillimin e parlamentarizmit në botë kanë evoluar raportet midis legjislativit dhe ekzekutivit dhe këto raporte kanë shprehur esencën e sistemit parlamentar. Edhe sot sistemi parlamentar si sistem i qeverisjes shtetërore bazohet në parimin e ndarjes fleksibile të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Bazë e këtij sistemi të qeverisjes është vendosja e balansit, ekuilibrit dhe barazpeshës midis legjislativit dhe ekzekutivit.³ Ky parim nënkupton, krahas pavarësisë së tre pushteteve edhe vendosjen e raporteve specifike të kontrollit reciprok politik të tyre. Vendosja e një balansi dhe ekuilibri midis tre pushteteve është bazë për funksionimin e demokracisë parlamentare në një shtet⁴. Balansi dhe ekuilibri i tre pushteteve në shtetet e demokracisë parlamentare duhet të arrijë dy qëllime kryesore: e para, të sigurojë pavarësinë e pushteteve: e dyta, ti kufizoj pushtetet, duke caktuar mekanizmat e kontrollit reciprok. Pra rëndësia e ndarjes së pushteteve qëndron në krijimin e një sistemi të kontrollit reciprok.⁵ Ky sistem në shtetet e demokracisë parlamentare duhet të sigurojë një stabilitet politik dhe një bashkpunim reciprok midis organeve dhe institucioneve shtetërore. Varësisht nga mënyra e përcaktimit të

³ Svetomir Shariq. Ustavno Pravo, Shkup, 1995, fq.377

⁴ Shih më gjësisht për këtë: Kim Meyer, "Marrdhënjet midis tre pushteteve dhe Stanelley Bach, "Struktura presidenciale, gjysëmpresidenciale dhe parlamentare", Matralet Kushtetuese, Tiranë, 1988

⁵ Prof.dr. Arsim Bajrami, Shqyrtimet e përgjithëshme për demokracinë parlamentare, "Thema", nr.16, Prishtinë, 2000, fq. 127.

këtij balansi kemi edhe modele të ndryshme të qeverisjes shtetërore, siq janë: sistemi parlamentar, presidencial, i përzier etj.

2. Parlamenti, si institucion politik

Paraqitja dhe zhvillimi i sistemit parlamentar ishte rezultat i një periudhe të gjatë të luftës së forcave demokratike për kufizimin e pushtetit dhe apsolutizmit të monarkut apsolut dhe për fitoren e sovranitetit popullor, të shprehur në institucionet politike përfaqësuese. Parlamenti si institucion politik në kuptimin bashkëkohor është paraqitur në shekullin XVII dhe XVIII, si një nga të arriturat e revulucionit borgjez dhe si një nga bazat e demokracisë qytetare dhe të shtetit qytetar. Realizimit të qeverisjes parlamentare , i parapriu lufta e gjatë në mes të aristokracisë dhe monarkut rreth kufizimit të pushtetit apsolut dhe bartjes së disa funksioneve në organet dhe institucionet përfaqësuese⁶.

Parlamenti, si institucion politik, ka lindur në Britani të Madhe, në periudhën e kalimit nga feudalizmi në kapitalizëm, periudhë tranzicioni që nuk qe e shkurtër dhe që u karakterizua për një kohë të caktuar nga ekuilibri ndërmjet fisnikrisë feudale dhe borgjezisë qytetare të posalindur dhe që kishte tendencë rritje⁷.

Krahas lindjes së parlamentit, janë shfaq edhe elementet e para të ekzekutivit, përkatësisht të qeverisë në kuptimin bashkëkohor. Këto embrione paraqiten dhe shprehen pas fitores definitive të regjimit parlamentar në Angli në vitin 1729. Në këtë vit përcaktohet parimi që kryeministri dhe qeveria, ndonëse kishin besimin e mbretit, duhet të përgjigjeshin edhe para parlamentit. Vetë mbretërit anglez erdhën në konkluzionin se ishte e domosdoshme që ministrat e caktuar prej tyre duhet të kishin edhe besimin e parlamentit. Në këtë kohë në praktikën kushtetuese të Anglisë (Anglia siq është e njohur nuk ka një kushtetutë të shkruar) u sanksionuan shprehimisht parimet e përgjegjësisë individuale dhe kolektive të ministrave para parlamentit, parime këto që shprehin esencën e regjimit parlamentar të qeverisjes.

⁶ Prof.dr. Arsim Bajrami, Teoria dhe Praktika Parlamentare, Prishtinë 1997, fq.61

⁷ Luan Omari, Sistemi parlamentar, Tiranë, fq.5

Pra sikur edhe vetë sistemi parlamentar, edhe qeveria e ka djepin e saj pikrisht në Angli. Me qëllim të evitimit të konflikteve me parlamentin rreth ndarjes së pushtetit, monarku ka formuar ekipin e bashkëpunorëve (këshilltarëve) të tij të cilët fillimisht mbanin përgjegjësi vetëm para monarkut, të cilit i jepnin llogari për punën e tyre. Më vonë, me qëllim të fitimit të përkrahjes së parlamentit, monarku caktonte ministrat nga rradhët e shumicës parlamentare. Nga ky moment qeveria, si organ fillon të diferencohet, sepse ministrat fillojnë të largohen nga kontrolli i drejtpërdrejtë i monarkut dhe të orientohen më tepër nga parlamenti, të cilit i paraqesin raport për punën e tyre. Kështu, qeveria, ndonëse, e zgjedhur formalisht nga mbreti lidhet organikisht me parlamentin, i cili fillon të ushtrojë kontrollin politik mbi punën e saj, duke përfshirë edhe të drejtën e shkarkimit të ministrave të caktuar apo të qeverisë si tërësi.

Më vonë me zhvillimin e parlamentarizmit në botë kanë evoluar raportet midis legjislativit dhe ekzekutivit dhe këto raporte kanë shprehur esencën e sistemit parlamentar. Edhe sot sistemi parlamentar si sistem i qeverisjes shtetërore bazohet në parimin e ndarjes fleksibile të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Bazë e këtij sistemi të qeverisjes është vendosja e balansit, ekuilibrit dhe barazpeshës midis legjislativit dhe ekzekutivit.⁸ Ky parim nënkupton, krahas pavarësisë së tre pushteteve edhe vendosjen e raporteve specifike të kontrollit reciprok politik të tyre. Vendosja e një balansi dhe ekuilibri midis tre pushteteve është bazë për funksionimin e demokracisë parlamentare në një shtet⁹. Balansi dhe ekuilibri i tre pushteteve në shtetet e demokracisë parlamentare duhet të arrijë dy qëllime kryesore: e para, të sigurojë pavarësinë e pushteteve: e dyta, ti kufizoj pushtetet, duke caktuar mekanizmat e kontrollit reciprok. Pra rëndësia e ndarjes së pushteteve qëndron në krijimin e një sistemi të kontrollit reciprok.¹⁰ Ky sistem në shtetet e demokracisë parlamentare duhet të sigurojë një stabilitet politik dhe një bashkpunim reciprok midis organeve dhe institucioneve shtetërore. Varësisht nga mënyra e përcaktimit të

⁸ Svetomir Shariq. Ustavno Pravo, Shkup, 1995, fq.377

⁹ Shih më gjësisht për këtë: Kim Meyer, "Marrdhënjet midis tre pushteteve dhe Stanelley Bach, "Struktura presidenciale, gjysëmpresidenciale dhe parlamentare", Matralet Kushtetuese, Tiranë, 1988

¹⁰ Prof.dr. Arsim Bajrami, Shqyrtimet e përgjithëshme për demokracinë parlamentare, "Thema", nr.16, Prishtinë, 2000, fq. 127.

këtij balansi kemi edhe modele të ndryshme të qeverisjes shtetërore, siq janë: sistemi parlamentar, presidencial, i përzier etj.

3. Raporti reciprok i legjislativit dhe ekzekutivit

Raportet e legjislativit dhe ekzekutivit janë të ndryshme në sistemet e qeverisjes parlamentare, parlamentare-presidenciale dhe presidenciale.

Në sistemet tipike parlamentare ekzekutivi (qeveria) jo vetëm formaliste, por edhe praktikisht ndodhet nën kontrollin politik të legjislativit. Ky kontroll manifestohet në dy forma: 1. qeveria buron nga parlamenti, d.m.th. zgjedhet dhe merr votëbesimi nga parlamenti dhe 2. qeveria gjendet nën kontrollin e plotë politik të parlamentit, i cili posedon instrumentet e kontrollit parlamentar.

Në sistemet e kombinuara të qeverisjes parlamentare-presidenciale raportet e legjislativit dhe ekzekutivit janë specifike dhe bazohen në kontrollin e dyfishtë politik të qeverisë, nga parlamenti dhe nga shefi i shtetit. Qeveria në këto sisteme mbanë lidhje të dyfishtë, sepse i nënshtrohet votëbesimit të dyfishtë. Ajo paraprakisht zgjedhet nga shefi i shtetit i cili mandaton kryeministrin dhe dekreton përbërjen e plotë të qeverisë, i cila më pastaj merr votëbesimin e dytë (votën inauguruese) në parlament. Kontrolli politik i qeverisë në këto sisteme ushtrohet nga shefi i shtetit dhe parlamenti. Shefi i shtetit (presidenti, kryetari) mundet në qdo kohë të merr votëbesimin kryeministrit dhe qeverisë në tërësi, e njëkohsisht edhe parlamenti ushtron kontrollin politik dhe mund të ngritë ose shtroj në qdo kohë mocionin e votëbesimit të qeverisë. Këtu kemi të bëjmë me të ashtuqujturin sistem bicefal ekzekutiv, ku ushtrimi i funksionit ekzekutiv ndahet midis qeverisë dhe shefit të shtetit. Shembell tipik i këtyre sistemeve pa dyshim është Republika e Pestë e Francës, e cila me Kushtetutën e saj të vitit 1958 (të ashtuqujturën Kushtetutë të De Golit) ka aplikuar një sistem hibrid të qeverisjes parlamentare-presidenciale, në të cilën kontrolli politik ndaj qeverisë ndahet midis presidentit dhe parlamentit.

Kontrolli politik i Qeverisë në sistemet tipike presidenciale i adresohet kryesisht presidentit. Ai në këto sisteme ushtron kontroll të plotë ndaj Qeverisë, qoftë në procesin e zgjedhjes së saj, apo në ushtrimin e kontrollit politik. Qeveria në këto sisteme nuk ka lidhje politike, me parlamentin por është në funksion të plotë të pushtetit presidencial dhe në implementimin e politikës shtetërore e cila koncipohet dhe përcaktohet nga presidenti. Model tipik i këtyre sistemeve është sistemi amerikan i qeverisjes shtetërore i bazuar në sistemin presidencial dhe shtetet tjera që bazohen në këtë model.

Kontrolli reciprok i legjislativit dhe ekzekutivit, krahas sigurimit të baraspeshës së këtyre dy degëve të pushtetit synon kontrollin reciprok përmes mekanizmave juridik dhe politik. Në këtë drejtim Prof. Savo Klimovski instrumentet e sigurimit të balansit dhe ekuilibrit reciprok i ndanë në mjete bashkëpunuese, përkatësisht koperuese dhe në mjetet e ndikimit (kontrollit reciprok). Si mjete bashkëpunues ai thekson “bashkëpunimin i legjislativit dhe ekzekutivit dhe ekuilibri reciprok sigurohet nëpërmjet këtyre mekanizmave juridik dhe politik: e para, qeveria ka të drejtën e nismës ligjdhënëse, pjesëmarrje në përcaktimin e rendit të ditës së parlamentit, pjesëmarrje në punën e parlamentit, në anën tjetër parlamenti ushtron kontroll permanent ndaj qeverisë dhe ka të drejtë të parashtojë pyetje deputetëve, të ngritë interpelanca, të formojë komisione të përhershme që e ndjekin punën e qeverisë, të formojë komisione të përkohëshme anketuese për përgjegjësinë e qeverisë.

Ndërkaq si mjet të ndikimit reciprok të legjislativit dhe ekzekutivit, autori veqon: kontrolli politik i parlamentit ndaj qeverisë dhe mundësia e qeverisë që të kërkojë shpërndarjen e parlamentit. Këto dy instrumente, ndonëse mund të rrezikojnë baraspeshën e këtyre degëve pushteteve paraqesin instrument me të cilin sigurohet kjo baraspeshë, në mënyrë që nuk siguron monopolin e një pushteti ndaj një pushteti.¹¹

4. Kontrolli parlamentar i egzekutivit

¹¹ Prof.dr. Savo Klimovski, Ustaven i Politiki sistem, Shkup, 1997, fq.726.

Parlamentarizmi si sistem i qeverisjes shtetërore, bazohet në primatin formal të legjislativit ndaj ekzekutivi dhe në raportet specifike midis këtyre dy pushteteve. Sot në teorinë kushtetuese dhe atë parlamentare, vazhdojnë të jenë të hapura debatet shkencore dhe profesionale rreth esencës së sistemit parlamentar. Në këtë drejtim sot dominojnë dy qasje themelore: e para ajo klasike, që me qeverisjen parlamentare nënkupton sistemin politik të bazuar në epërsin formale të parlamentit dhe kontrollin politik që ai ushtron ndaj ekzekutivit dhe qasja e dytë, që esencën e sistemit parlamentar e sheh në rolin e avansuar dhe të pavarur të ekzekutivit (qeverisë), i cili edhe pse buron nga legjislativi paraqet qendër kryesore të udhëheqjes së shtetit, jo vetëm në kuptimin e zbatimit të ligjeve dhe politikës shtetërore të përcaktuar nga legjislativi (parlamenti) por edhe të kreimit dhe koncipimit të sistemit juridik dhe politikës shtetërore. Ithtarët e qasjes së dytë, përfaqësojnë mendimin për rolin aktiv të qeverisë dhe zbehjen e ndikimit të legjislativit në kontrollin politik ndaj ekzekutivit.

Megjithë mendimet e ndryshme për esencën e parlamentarizmit dhe tentencat e zhvillimit të tij bashkëkohor, të gjithë teoricientët që merren me qështje kushtetuese dhe teorinë dhe praktikën parlamentare pajtohen se pikrisht raportet e legjislativit dhe ekzekutivit si dhe instrumentet e kontrollit politik paraqesin element kryesor për identifikimin e modelit të sistemit parlamentar që zbatohet në një shtet. Raportet e legjislativit dhe ekzekutivit nuk janë vetëm qështje teorike dhe shkencore, por edhe ligjore dhe varen nga dispozitat kushtetuese, që përcaktojnë këto raporte.

5. Raporti i legjislativit dhe ekzekutivit si faktor i krizave parlamentare

Demokracitë moderne karakterizohen nga vendimmarrje të ndara midis degëve ekzekutive dhe legislative. Në përgjithsi kushtetuta e një vendi formalisht ndërton këtë bashkëveprim. Në praktikë, precedenti dhe zakoni më pastas i përmbushin zbrazëtirat me qëllim të krijimit të sistemit politik nën të cilin një qeveri udhëheq në bazë të përditshme. Meqëse këto rrethana ndryshojnë shumë prej vendit në vend, demokracitë ndryshojnë plotësisht në mënyrën se si fuqia politike ndahet dhe në ndikimin relativ që çdo degë e qeverisjes e ka në formulimin e politikës.

Praktikat e pranuara në një demokraci të suksesshme mund të jenë të papërfytyrueshme ose bile edhe jokushtetuese në një demokraci tjetër barazisht kumbuese. Shëndeti i demokracisë keqësohet menjëherë , mirëpo kur dega ekzekutive jashtë mase dominon mbi legjislativin.

Organi ligjvënës është komponenta kryesore e qeverisjes demokratike. Në fakt, nevoja për një organ legjislativ të fortë reflektohet domethënien e fortë të demokracisë ” sundim i popullit”. Me qëllim që njerëzit të sundojnë atyre ju duhen mekanizma që ti përfaqësojnë dëshirat e tyre, të bëjnë politik në emër të tyre dhe të vëzhgojnë implementimin e këtyre politikave.

Krahas nevojës për një organ legjislativ të fortë, shumë organe legjislative janë të dominuara në mënyrë dërmuese nga dega ekzekutive. Ky problem është posaçërisht i përhapur në demokracitë që dalin në shesh. Derisa zgjedhjet demokratike në këto shtete mund të rezultojnë në organe legjislative shumëpartiake ato rrallë prodhojnë institucione të forta demokratike. Në mënyrë tipike, organeve të reja legjislative shumëpartiake ” ju mungon organizimi, burimet financiare, mjetet, antarë me përvojë dhe trup i cili do të shërbejë pikë e matur dhe autonome diskutimi në procesin politik. Në mes të një trashëgimi të degës dominante ekzekutive, legjislatorët në këto shtete janë herë pas here të paafte të parashikojnë ose të krijojnë vetë ’ një fushë të luajtjes në nivel’ në të cilën organi legjislativ merr pjesë tërësisht në nxjerrjen e ligjeve dhe kontrollimit të pushtetit ekzekutiv.

Në pothuajse të gjitha demokracitë udhëheqësit e degës ekzekutive në mënyrë tipike drejtojnë pothuajse pushtetin politik, kontrollojnë burimet financiare, posedojnë staf i cili është i përkushtuar në zhvillimin e politikave dhe implementimin e ligjeve, përgatisin pjesën më të madhe të legjislacionit dhe menaxhojnë kontratat e qeverisë dhe administrojnë programet e qeverisë. Nëse organet e reja legjislative do të kenë rol qendror në qeverisjen e një kombi, atëherë u takon ligjvënësve të ndërtojnë institucione të forta legjislative, duke kategorizuar veten në funksionin e nxjerrjes së rregullt të ligjeve ose nëpër ndryshime specifike strukturore nëpërmjet amendamenteve kushtetuese, legjislacionit ose rregullave të procedurës.

Kapitulli i dytë

I Aspekti teorik i krizave parlamentare

1. Kuptimi i krizave parlamentare

Kriza parlamentare paraqet një fenomen kompleks kushtetues dhe politik që mund të përkufizohet nga aspektet e ndryshme. Kryesisht janë dy aspekte kryesore të përkufizimit dhe manifestimit të krizave parlamentare.

Në aspektin kushtetues dhe politik, kriza parlamentare paraqet situatën në të cilën nuk mund të zbatohen dispozitat kushtetuese për funksionimin e tri pushteteve dhe degëve të qeverisjes. Kjo nënkupton bllokimin kushtetues të funksionimit të parlamentit, qeverisë dhe presidentit. Ky bllokim kushtetues pengon funksionimin e sistemit kushtetues të një shteti dhe pamundëson ushtrimin e funksioneve vitale të shtetit si psh; ligjvënien, formimin dhe funksionimin e qeverisë, funksionimin e presidentit të shtetit etj. Jo çdo pengesë kushtetuese e funksionimit të pushtetit trajtohet si krizë parlamentare. Atributin e krizës parlamentare e kanë vetëm situatat serioze që pengojnë funksionimin e pushtetit.

1.1 Krizat parlamentare në aspektin kushtetues

Krizat parlamentare shprehin këto tri tipare kryesore, edhe ato

- Pamundësia e konstituimit të parlamentit në afatin kushtetues, brenda periudhës së përcaktuar kushtetuese
- Pamundësia e zgjedhjes dhe konstituimit të qeverisë në afatin kushtetues
- Bllokimi i zgjedhjes së presidentit, në rastin kur ai zgjedhet nga ana e parlamentit
- Situatat tjera kur nuk mund të realizohen dispozitat kushtetuese për funksionimin e këtyre tri organeve në funksionet e tyre vitale.

Në aspektin kushtetues krizat parlamentare shprehen edhe përmes konflikteve kushtetuese midis organeve të pushtetit dhe manifestohen përmes këtyre formave;

- Konfliktet kushtetuese në mes presidentit dhe parlamentit rreth zgjedhjes së Kryeministrit dhe qeverisë dhe mundësia kushtetuese e shpërndarjes së parakohëshme e parlamentit na ana e presidentit,
- Konfliktet kushtetuese midis parlamentit dhe qeverisë, përkatësishtë përdorimi i mocionit të votëbesimit të qeverisë dhe rënia kushtetuese e qeverisë,
- Konfliktet kushtetuese rreth shkarkimit të presidentit në procedurën e impiqmentit dhe zëvendësimi i përkohëshëm i presidentit të shkarkuar etj.

Një formë më e vrazhdë kushtetusemanifestimit të krizave parlamentare paraqesin shkeljet dhe cenimet e rënda të dispozitave kushtetuese, të cilat kanë të bëjnë me respektimin e ekuilibrit kushtetues midis tre pushteteve dhe cenimit të rëndë të parimit të ndarjes së tre pushteteve. Në këto raste vije deri te dezekulibrimi i pushteteve ndëryhrja jokushtetuese e një pushteti në tjetrin dhe marrja jokushtetuese e kompetencave. Kriza parlamentare në situatat e këtilla merr dimensione të krizes së thellë politike dhe shtetëtoe në një vend dhe mund të rezultojë me tendenca të diktaturës dhe anarkisë së thellë politike.

Përderisa përkufizimi kushtetuese i krizave parlamentare merr për bazë pamundësinë e realizimit,ose cenimin e rëndë të Kushtetutës, në aspektin politik kriza parlamentare përkufizohet kryesishtë me motive politike. Dimensioni politik i koncipon krizat parlamentare si një strategji permanente politike të opozitës parlamentare për të ushtruar kontrollin politik të qeverisë, për të shtruar mocionin e votëbesimit të qeverisë dhe për të imponuar zgjedhje të parakohëshme parlamentare si një objektivë legjitime opozitare.

1.2 Krizat parlamentare në aspektin politik krizat parlamentare

Krizat parlamentare në aspektin politik krizat parlamentare shprehin këto manifestime kryesore;

- Bllokimi i punës së parlamentit për shkak të obstrukcioneve parlamentare të opozitës

- Pamundësia e zgjedhjes së qeverisë si rezultat i muneses së mazhorancës parlamentare
- Kriza e koalicionetve parlamentare dhe qeveritare, shthurja e këtyre koalicioneve dhe rënia e qeverisë,
- Bllokimi i zgjedhjes së presidentit nga opozita si rezultat i mungesës së konsensusit politik për zgjedhjen e tij.

2. Elementet e krizave parlamentare

Kriza parlamentare në vartësi nga shkaqet e paraqitjes së saj shprehet përmes elementeve të caktuara që shprehin bllokimin e funksionimit të sistemit kushtetues dhe të demokracisë parlamentare në një vend. Më poshtë do të cekim elementet kryesore të shprehjes së krizave parlamentare sipas formave kryesore të manifestimit të saj.

2.1. Bllokimi i punës së parlamentit

Kur kriza parlamentare shprehet në bllokimin e punës së parlamentit, ajo shprehet përmes këtyre elementeve;

- Pamundësia e konstituimit të parlamentit pas zgjedhjeve,
- Pamundësia e parlamentit për ti ushtruar tri funksionet e tij vitale
- Pamundësia e ushtrimit të funksionit kushtetues dhe legjislativ
- Pamundësia e zgjedhjes së qeverisë,
- Pamundësia e zgjedhjes së presidentit,
- Pamundësia e funksionimit normal të parlamentit, munesa e kuorumit, mungesa e shumicës parlamentare për votimin e ligjeve,
- Elementet tjera që pamundësojnë parlamentit të ushtrojë rolin e tij kushtetues.

2.2 Raporti midis parlamentit dhe qeverise

Elementet e krizes parlamentare në raportet midis parlamentit dhe qeverisë janë;

- Mungesa e mazhorancës parlamentare për votimin e qeverisë.
- Dështimi i zgjedhjes së qeverisë pas disa xhirove të votimit për zgjedhjen e saj,
- Votimi i mocionit të mosbesimit të qeverisë,
- Mosvotimi i buxhetit dhe rënia e qeverisë,
- Kriza e koalicionit qeverisës, rënia e qeverisë
- Dorëheqja e kryeministrit dhe rënia e qeverisë
- Mosvotimi i ligjeve sistemore të qeverisë në parlament,

2.3 Raportet në mes të parlamentit dhe presidentit

Elementet e krizes parlamentare në raportet në mes të parlamentit dhe presidentit;

- Dështim i zgjedhjes së presidentit në parlament,
- Shkarkim i presidentit në procedurën e impiqmentit,
- Shpërndarja e parlamentit nga ana e presidentit,
- Konflikti për kompetencë mes parlamentit dhe presidentit në sferën e luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme dhe në politiken e jashtme,
- Pakjartësia rreth zëvendësimit të presidentit në rastë impiqmenti ose pamundësie tjetër për të ushtruar funksionin.

2.4 Krizat parlamentare si rezultat i veprimit opozitar

Elementet e krizes parlamentare si rezultat i veprimit opozitar,

- bllokimi i punës së parlamentit,
- mungesa e kuorumit për mbajtjen e mbledhjeve të parlamentit
- bojkoti parlamentar dhe pamundësia e votimit të ligjeve
- interpelancat parlametare dhe votimi i mosbesimit të qeverisë,

Kapitulli i tretë

I Analiza kauzale e krizave parlamentare (shkaqet dhe pasojat)

1.Krizat parlamentare- shkaqet e paraqitjes

Krizat parlamentare janë fenomene tipike për sistemet multipartiake dhe për demokracitë proporcionale. Në aspektin parlamentar kriza parlamentare nënkupton pamundësinë e parlamentit për të ushtruar funksionet e veta kushtetuese. Në radhë të parë, kjo pamundësi shprehet në bllokimin e parlamentit në ushtrimin e funksionit legjislativ dhe në zgjedhjen e qeverisë. Krizat parlamentare mund të paraqiten gjatë gjithë mandatit parlamentar, dhe nëse ato zgjasin një kohë të gjatë mund të shkaktojnë kriza të thella politike dhe pengesa serioze në funksionimi e demokracisë.

Arsyet e shfaqjes dhe format e manifestimit të krizave parlamentare janë të ndryshme. Në praktiken parlamentare burimet më të shpeshta të shfaqjes së krizave parlamentare janë:

1.1. Mungesa e mazhorancave stabile parlamentare

Paraqet burimin kryesor i shfaqjes së krizave parlamentare. Kjo vjen në shprehje kur zgjedhjet parlamentare nuk kanë nxjerr një fitues absolut të zgjedhjeve, përkatësisht nuk kanë krijuar një mazhorancë parlamentare. Në këto raste ka vështirësi në funksionimin e parlamentit, e në radhë të parë në zgjedhjen e qeverisë. Në rast se nuk ndërtohen koalicionet stabile parlamentare, vështirë mund të zgjedhet një qeveri stabile dhe të formohet një qeveri e koalicionit. Kjo situatë është tipike për shtetet me sisteme multipartiake që zbatojnë sistemet proporcionale elektorale. Në këto raste kriza parlamentare mund të evitohet me krijimin e koalicioneve stabile parlamentare. Në të kundërtën, si pasojë e pamundësisë së krijimit të qeverisë, kriza parlamentare mund të imponoi shpërndarjen e parlamentit dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në praktikën parlamentare, mungesa e mazhorancave paraqet burimin kryesor të krizave parlamentare, sepse kjo krijon një situatë bllokuese në parlament

dhe pamundëson zgjedhjen e qeverisë dhe të institucioneve të tjera. Janë të njohura rastet e shumta të bllokimit të punës së parlamentit si pasoje e mungesës së mazhorancës parlamentare. Po përmendim me këtë rast krizën parlamentare të shfaqur me rastin e zgjedhjeve të para parlamentare në Kosovë të mbajtura në vitin 2002, ku si pasojë e mungesës së mazhorancës parlamentare dhe një fituesi absolut të zgjedhjeve, për dy muaj të tërë nuk arrit të formohet qeveria dhe të zgjedhet Presidenti i Kosovës. Vetëm në sajë të një marrëveshje politike dhe formimit të një qeverie të koalicionit të gjerë u evitua kjo krizë parlamentare dhe u zgjodh qeveria dhe Presidenti i Kosovës. Te demokracitë dypartiake nuk ka probleme në krijimin e mazhorancave parlamentare sepse atëherë zbatohet sistemi mazhoritar i zgjedhjeve që gjithëherë nxjerrë një fitues absolut të zgjedhjeve parlamentare.

1.2. Konfliktet në mes parlamenti dhe presidenti rreth zgjedhjes së Kryeministrit dhe qeverisë

Paraqesin një burim tjetër i shfaqjes së krizave parlamentare. Këto konflikte janë të karakterit kushtetues dhe bazohen në të drejtën e presidentit që të caktojë dhe propozojë parlamentit mandatarin për formimin e qeverisë dhe të dekretoj qeverinë. Konflikti lind atëherë kur parlamenti refuzon ti jep votëbesimin kryeministrit të propozuar nga presidenti. Nëse ky refuzim përsëritet edhe në turrat tjera të votimit parlamentar, atëherë presidenti sipas shumicës së kushtetutave të shteteve gjysmëpresidenciale, ka të drejtë të bëjë shpërndarjen e parlamentit dhe e të shpall zgjedhje të reja të parakohshme parlamentare. Me këtë rast kriza parlamentare, zgjedhet në atë mënyrë që përmes shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme tentohet të krijohet një mazhorancë tjetër parlamentare, e cila do të votojë qeverinë e re. Kriza parlamentare me këtë rast ka karakter kushtetues, sepse vë në pyetje autoritetin presidencial për të zgjedhur kryeministrin. Zakonisht, kjo nuk ndodhë te demokracitë mazhoritare, ku presidenti dhe monarku propozojnë liderin e partisë fitues për kryeministër, dhe ai pa problem të theksuar merr votëbesimin e mazhorancës parlamentare. Kjo vjen në shprehje në sistemet multipartiake parlamentare, ku për votimin e qeverisë nevojiten koalicionet parlamentare. Rastet e shfaqjes së krizave

parlamentare, si pasojë e refuzimit të kandidatit për kryeministër të propozuar nga presidenti janë të shumta. Me këtë rastë po përmendim rastin e Federatës Ruse, kur Presidentit Mihail Gorbaqov dy herë Duma Ruse (dhoma e ultë e parlamentit rus), i refuzoj kandidatin reformatör për kryeministër. Para votimit në raundin e tretë dhe vendimtar, ai kërcënoi me shpërndarje Dumen Ruse dhe ky kërcënim ndikoi, që ajo të pranoj kandidatin presidencial për kryeministër dhe të evitojë shpërndarjen e parakohshme. Madje, disa analistë parlamentar, theksojnë se disa anëtarë të Dumes ruse, të dominuar nga komunistet dhe radikalet, që më parë kishin refuzuar kandidatin e presidentit për kryeministër, tani e votuan zëshëm, madje duke ngritur disa prej tyre edhe nga dy duart. Sigurisht se në këtë ka ndikuar mundësia e pakontestuar kushtetuese e presidentit për ta shpërndarë para kohe Dumen Ruse, që për deputetet do të thotë humbje e shumë privilegjeve parlamentare, nga të cilat ata nuk heqin lehtë dorë, përkundrajt inateve politike që mund të kenë.

1.3. Dështimi i koalicioneve parlamentare dhe qeveritare

Dështimi i koalicioneve parlamentare dhe qeveritare dhe pamundësia e ndërtimit të koalicioneve të reja mund të shkaktojë krizë parlamentare dhe qeveritare. Kjo vjen në shprehje, kur koalicionet bien në krizë, ose shpërbëhen me çka vije në krizë mazhoranca parlamentare. Situatë e njëjtë e krizës parlamentare paraqitet edhe kur koalicioni qeveritar shpërbëhet me tërheqjen nga qeveria të partnerëve të koalicionit, të cilët tërhiqen edhe nga mazhoranca ekzistues parlamentare, që ndikon që qeveria të humb besimin e mazhorancës dhe të rrëzohet lehtë nga opozita përmes mocionit të mosbesimit të kërkuar nga opozita. Rastet më të shpeshta të shfaqjes së krizave parlamentare sipas këtij burim i hasim në Itali, Francë dhe Gjermani. Në këto shtete zakonisht formohen koalicionet parlamentare dhe qeveritare si rezultat i spektrit multipartiak në parlament. Në Itali janë të rralla qeveritë që kanë përfunduar mandatin e plotë për të cilin janë zgjedhur. Madje, ka ndodhur që brenda vitit të ndërrohen 3, deri në 5 qeveri si rezultat i dështimit të koalicioneve politike.

1.3. Mosvotimi i buxhetit nga parlamenti

Mosvotimi i buxhetit nga parlamenti është një shprehje e mosbesimit ndaj qeverisë, e cila është propozuese e buxhetit. Në praktiken parlamentare, jo rrallë mosvotimi i buxhetit shkakton dorëheqjen e qeverisë dhe shpërndarjen e parakohshme të parlamentit. Buxheti paraqet një nga aktet më të rëndësishme për qeverinë dhe mosmiratimi i tij vë në pyetje funksionimin e institucioneve që varen nga buxheti publik.

1.5 Obstruksioni parlamentar nga ana e opozitës

Obstruksioni parlamentar nga ana e opozitës mund të ndikojë në shfaqjen e krizave parlamentare, nëse kjo rezulton me bllokimin e punës dhe vendimmarrjes në parlament. Jo rrallë, opozita përdorë obstruksionet parlamentare për të bllokuar punën e parlamentit, vendosjen për çështjet e ndryshme dhe format tjera të obstruksionit. Format më të njohura të obstruksionit parlamentar të opozitës janë: bojkoti i seancave parlamentare, zvarritja e debatit parlamentar përmes fjalimeve të gjata, presionet jashtëparlamentare përmes protestave dhe formave të tjera, paraqitja e amendamenteve të shumta me qëllim të zvarritjes së miratimit të ndonjë ligji në parlament etj. Këto forma të obstruksioneve parlamentare mund të bllokojnë procesin e vendimmarrjes në parlament në rastet kur ai ka një mazhorancë të brishtë parlamentare dhe nuk ka një shumicë të nevojshme për votimin e ligjeve, sidomos në raste kur kërkohet shumica e kualifikuar prej dy të tretave.

Kapitulli i katert

I Mënyrat e tejkalimit të krizave parlamentare

1. Shpërndarja e parlamentit

Shpërndarja e parlamentit paraqet një institucion parlamentar që nënkupton përfundimin e mandatit të para skadimit të mandatit të rregullt për të cilin është zgjedhur. Shpërndarja e parlamentit vjen si pasojë e rrethanave të caktuara kushtetues dhe politike, të cilat bllokojnë punën e tij, bëjnë të pamundshëm ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe krizave të thella parlamentare, të cilat nuk mund të tejkalohen me mjete tjera politike.

Shumica e kushtetutave njohin institutin e shpërndarjes së parakohshme dhe përcaktojnë procedurat e shpërndarjes. Si rrethana kryesore kushtetuese që ndikojnë në shpërndarjen e parakohshme janë; konfliktet në mes presidentit dhe parlamentit rreth zgjedhjes së kryeministrit dhe qeverisë, votimi i mocionit të mosbesimit të qeverisë, mos votimi i buxhetit, krizat e thella parlamentare etj.

Rastet më të shpeshta të shpërndarjes së parlamentit, vinë si pasojë e pamundësisë së zgjedhjes së qeverisë dhe konfliktit kushtetues në mes presidentit dhe parlamentit rreth zgjedhjes së kryeministrit dhe qeverisë. Këto raste paraqiten në sistemet parlamentare dhe ato gjysmëpresidenciale, në të cilat Kryetari i shtetit ka të drejtë të propozojë kandidatin për kryeministër. Në rast se parlamenti në disa raunde të votimit refuzon të emërojë kandidatin e propozuar, Kryetari i shtetit ka fuqi kushtetuese për ta shpërndarë parlamentin dhe për të shpallur zgjedhje të parakohshme. Kushtetuta e Francës në nenin 12 shprehimisht përcakton se “Presidenti i Republikës pasi dëgjon Kryeministrin dhe kryetaret e dy dhomave, mund ta shpërndajë Asamblenë Kombëtare. Zgjedhjet e reja mbahen të paktën 20 ditë dhe të shumtën 40 ditë pas shpërndarjes”. Të njëjtën mundësi e përcakton edhe Kushtetuta e Italisë në nenin 88 e cila njeh të drejtën që “Presidenti i Republikës pasi dëgjon Kryetaret e tyre, mund të shpërndajë Dhomat ose vetëm njëërën prej tyre. Këtë kompetencë nuk mund ta ushtrojë në gjashtë muajt e fundit të mandatit të tij” Në Angli kompetenca e shpërndarjes së parlamentit është në duart e Kurorës, e cila për këtë konsultohet me Kryeministrin.

Në fakt, de facto rolin kryesor në shpërndarjen e Dhomës së Komunave në Angli e ka Kryeministri, i cili i propozon Kurorës shpërndarjen e parlamentit. Një zgjedhje e ngjashme përcaktohet edhe me shumë kushtetuta të demokracive parlamentare, kurse procedurat e shpërndarjes së parlamentit përcaktohen me rregulloret e brendshme të tyre. Edhe pse shpërndarja e parlamenteve bikamerale mund të përfshi të dy dhomat, në praktik zakonisht kjo ka të bëjë me Dhomën e Ulhtë, si dhomë legjislative e zgjedhur drejtpërdrejt nga zgjedhësit.

Për dallim prej demokracive parlamentare dhe atyre gjysmëpresidenciale, në SHBA nuk njihet e drejta e Presidentit për të shpërndarë Kongresin. Pa dyshim se kjo është rrjedhojë e parimit të balancimit dhe ekuilibrit të tri pushteteve, që nuk lejon epërsinë e një pushteti ndaj tjetrit.

Instituti i shpërndarjes së parlamentit e njohin edhe sistemet parlamentare në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Sipas nenit 9.1.5 të Kornizës Kushtetues të paktën dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit mund të kërkojnë nga PSSP-ja të shpërndajë Kuvendin. Një kërkesë të këtillë PSSP-së ja komunikon Kryetari i Kosovës. Nga kjo rrjedh se në fakt, Korniza Kushtetues njeh vetëm mundësin e vetë shpërndarjes së Kuvendit, që është një rast shumë i rrallë në praktikat parlamentare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 96, përcakton se, Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend. Në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve. Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin. Efektet e shpërndarjes së parakohshme të parlamentit janë:

1. përfundimi i mandateve të deputetëve;
2. përfundimi i mandatit të qeverisë, e cila vazhdon të punojë në dorëheqje deri në zgjedhjen e qeverisë së re;
3. shpallja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

2. Koalicionet parlamentare dhe qeveritare

Koalicionet parlamentare dhe qeveritare janë instrumente politike që nënkuptojnë bashkimin e dy apo më shumë partive politike me qëllim të krijimit të mazhorancave parlamentare dhe qeverisë së koalicionit. Si rregull koalicionet parlamentare ndërtohen me marrëveshje politike në mes të partive politike të orientimit të përafërt politik, por në praktik jo rrallë koalicionet ndërtohen edhe nga partitë politike me orientime të ndryshme politike. Ndërtimi i koalicioneve është një proces negocues politik, ku partitë politike shprehin interesat e veta dhe arrin marrëveshje për qeverisje të përbashkët. Marrëveshja për ndërtimin e koalicioneve politike paraqet bazë politike për krijimin e qeverisë, ndarjen e posteve ministrore dhe aspektet tjera të qeverisjes së përbashkët. Zakonisht koalicionet janë pjesë e bisedimeve politike të udhëheqësve partiak dhe kandidatit për kryeministër, i cili si rregull i prinë bisedimeve për krijimin e koalicionit qeverisës. Koalicionet politike mund të klasifikohen sipas dy kritereve kryesore:

Në bazë të kohës së lidhjes së tyre janë të njohura koalicionet parazgjedhore dhe ato paszgjedhore.

2.1 Koalicionet parazgjedhore

Koalicionet parazgjedhore ndërtohen më herët para fillimit të ciklit elektoral dhe rezultojnë me një listë të përbashkët zgjedhore të dy ose më shumë partive politike që janë pjesë e koalicionit. Në këtë rast partitë politike para zgjedhjeve ndërtojnë koalicionin dhe me marrëveshje hartojnë një listë të përbashkët zgjedhore sipas sistemit proporcional ose mazhoritar, zhvillojnë një fushatë të përbashkët dhe në rast të fitores zgjedhore ndërtojnë qeveri të përbashkët të koalicionit. Shembull tipik i kësaj strategjie të ndërtimit të koalicioneve politike është Shqipëria, ku Partia Demokratike para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, arriti një koalicion të gjerë të përbërë nga disa parti tjera politike, të cilat zhvilluan një fushatë të përbashkët elektorale dhe formuan qeverinë e përbashkët pas fitores elektorale.

2.2 Koalicionet paszgjdhere

Koalicionet paszgjdhere, ose qeveritare formohen pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare si rezultat i mungesës së mazhorances parlamentare dhe nevojës së krijimit të qeverisë së koalicionit. Me këtë rast qeveria formohet si rezultat i formimit të koalicionit qeveritar në bazë të marrëveshjes për zgjedhjen e kryeministrit dhe ndarjes së posteve ministrore. Përmes kësaj marrëveshje evitohet kriza parlamentare. Këto forma të koalicioneve janë më të shpeshta në praktiken parlamentare dhe funksionojnë në shtetet multipartiake.

2.3 Koalicionet bilaterale

Në bazë të numrit të partive që formojnë koalicionet politike, janë të njohura *koalicionet bilaterale* që ndërtojnë dy parti politike dhe *koalicionet e gjëra* që përfshinë një spektër të gjerë të partive politike në pushtet. Në rastin e parë, dy parti politike, njëra e madhe, kurse tjetra e vogël formojnë koalicionin politik dhe mazhorancën parlamentare, e cila qeverisë vendin. Në këtë rast në parlament vepron një opozitë e fuqishme e cila nuk përfshihet me koalicion dhe që ushtron kontroll politik ndaj qeverisë. Në rastin tjetër ndërtohet një bashkëqeverisje e gjerë e shumicës së partive politike parlamentare, pa një opozitë të fortë dhe pa kontroll parlamentar të ekzekutivit. Shembull tipik i këtyre koalicioneve mund të merret Kosova, ku pas zgjedhjeve të para parlamentare u krijua koalicioni i gjerë qeverisës i tri partive kryesore politike, LDK, PDK, AAK dhe partive të minoriteteve dhe një sistem i bashkëqeverisjes së gjerë pa një opozitë të mirëfilltë. Rasti tjetër janë zgjedhjet e dyta parlamentare kur koalicionin qeverisës e përbëjnë dy parti politike, LDK dhe AAK, kurse partitë tjera politike përbëjnë opozitën parlamentare, e cila mund të ushtrojë kontrollin politik të qeverisë.

Në bazë të kriterëve tjera, koalicionet politike mund të ndahen në ato që formohen nga partitë e orientimit të njëjtë programor, si p.sh. partitë e majta, të djathta dhe koalicionet e përbëra nga partitë e orientimeve të ndryshme që ndryshe mund të quhen edhe koalicione të panatyrshme, përkatësisht koalicione interesash politike

3. Krizat parlamentare dhe dhe opozita¹²

Që qeveria e një shteti demokratik në udhëheqjen e politikës së mbrendshme dhe asaj të jashtme është gjithnjë qeveri partiake, kjo tregohet më së miri në ekzistencën e opozitës parlamentare, e cila në parlament gjendet përballë shumicës qeveritare. Në kushte normale, tërësia e forcave politike të një kombi përbëhet nga qeveria dhe opozita. Opozita – siç thuhet me të drejtë – është faktor i rëndësishëm përballë qeverisë. Ekzistenca e opozitës pengon identifikimin e partisë qeveritare me shtetin, shndërrimin e saj në parti shtetërore dhe paraqitjen e interpretimit të saj të së mirës së përbashkët si absolut dhe të vetëm.

Institucioni i opozitës parlamentare është ndikuar nga dy bindje themelore të cilat bëjnë pjesë në elementet themelore të formimit demokratik të shtetit. Së pari bindja se demokracia e fiton dinamikën e saj nëpërmjet konflikteve politike dhe sociale. Tërësia e pikëpamjeve dhe interesave, me ndihmën e të cilave mund të përballohen vështirësitë e paraqitura.

3.1 Opozita si kundërpushtet

Opozita e mundësuar nga demokracia dhe e konsideruar si e domosdoshme del edhe nga një përvojë tjetër e rëndësishme e jetë politike. Ai që është i bindur për ndikimin negativ të pushtetit të tepruar, në demokraci duhet të ketë parasysh shumën e të gjitha masave për parandalimin e këtij rreziku me ndihmën e një kontrolli sistematik të pushtetit. Kundërpesha më me ndikim dhe më e rëndësishme ndaj pushtetit, që prej kohësh ka qenë opozita parlamentare. Sipas teoricientëve anglo – saksonë të parlamentit të shek. XVII, zbuluesve të vërtetë të opozitës parlamentare, qeveria dhe opozita dallohen në kontradiktën mes zotërimit të pushtetit dhe jopushtetit edhe në aspektin moral. Sipas tyre, djallëzia e pushtetit rrezikon vetëm qeverinë, së cilës me pasjen e pushtetit i kanoset rreziku i korrupsionit. Detyrë e opozitës është pra mbrojtja nga ky zhvillim negativ. Nëpërmjet institucionalizimit të opozitës, sipas tyre, duhet të

¹² [E tërë pjesa e parë e punimit është nxjerrë nga: Waldemar Besson/Gotthard Jasper, Das Leitbild der modernen Demokratie, Bauelemente einer freiheitlichen Staatsordnung, Bonn 1990]

ruhet liria, duke iu dhënë njeriut, e sidomos të fuqishmëve një masë kultivimi, detyrë e së cilës është parandalimi i shndërrimit të lirisë në anarki apo despotizëm.

Ideja e opozitës parlamentare përbën për këtë arsye përpjekjen për mposhtjen e të metave të njeriut dhe kontributin në bashkësinë njerëzore përmes veprimit, ekuilibrit, kritikës. Opozita shndërrohet në këtë mënyrë në një funksion të udhëheqjes politike, gjë që në Angli realizohet përmes dhënies së pagës nga ana e shtetit për udhëheqësin e opozitës, si dhe duke e cilësuar opozitën si ‘ Her Majesty’s Opposition’. Për këtë arsye, institucionalizimi i kufizimit të pushtetit politik në qeveritë parlamentare përmes krijimit të një opozite është quajtur si ‘një ndër zhvillimet më të rëndësishme të fondit jo aq të pasur me institucione politike’ (Otto Kirchheimer).

3.2. Opozita si alternativë

Realizimi i idesë së opozitës parlamentare në vendin klasik të sistemit dypartiak në Angli nuk ka qenë i rastit. Në sistemet dypartiake, loja mes qeverisë dhe partisë në pushtet nga njëra anë dhe opozitës në anën tjetër, mund të funksionojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive. Opozita në sisteme të tilla, në kushte normale, nuk ka mundësi të rrëzojë qeverinë gjatë periudhës legjislative, derisa kjo e fundit mund të mbështetet në shumicën e partisë së saj. Por ky fakt nuk e kufizon mundësinë politike të opozitës.

Ajo ushtron ndikimin e saj ndaj qeverisë edhe me faktin se qëndron gati për ta zëvendësuar qeverinë jo të suksesshme në zgjedhjet e ardhshme. Për këtë arsye, ajo kritikon në parlament masat e qeverisë dhe i parashtrohet asaj një program më të mirë, për t’i bindur kështu votuesit për domosdoshmërinë e zgjedhjes së një qeverie të re. Gjasat për të ardhur në pushtet pas zgjedhjeve të ardhshme e shtojnë opozitën që të jetë e matur me kritikën dhe kundërpropozimet e saj. Qeveria ndërkaq detyrohet të fillojë betejën për të fituar besimin e zgjedhësve. Kritika e opozitës e zhvilluar në parlament e detyron atë që të përgjigjet dhe të paraqesë më mirë pozicionin e saj. Jo rrallë, qeveria do ta ndryshojë edhe pozicionin e saj për shkak të ndikimit të argumenteve të opozitës. Një udhëheqje largpamëse e shtetit do t’i përvetësonte idetë

dhe planet e opozitës, natyrisht në dëm të kundërshtarëve të saj, por edhe në dobi të shoqërisë. E tërë kjo ndodh para syve të zgjedhësve, të cilët luajnë rolin e gjykatësit të paanshëm, duke marrur vendimin e tyre në çdo katër apo pesë vjet. Me qëllim informimin e tyre, mbledhjet e parlamentit mbahen shpesh publike.

3.3 Funkzioni kontrollues i opozitës

Edhe angazhimi i rregullt politik i opozitës në parlament ka rëndësi të madhe. Meqenëse partia shumicë apo koalicioni partiak, nga i cili ka dalë qeveria nuk ka shumë prirje dhe shkas për të kontrolluar në mënyrë rigoroze instancën ekzekutive, opozita duhet të marrë edhe rolin e kontrolluesit, rol ky të cilin, vetëm në sistemet presidenciale të qeverisjes si ai i SHBA – së, e ushtron parlamenti si i tërë. Linja e vërtetë politike e ndarjes në sistemet parlamentare, në kushte normale, nuk është ajo mes qeverisë dhe parlamentit, ekzekutivit dhe legjislativit, por ajo mes qeverisë dhe partisë qeveritare apo koalicionit qeveritar nga njëra anë dhe/ose partive opozitare nga ana tjetër. Ndarja klasike e pushtetit zëvendësohet pra me një ‘ndarje vitale të pushtetit’. Megjithatë nuk duhen mbivlerësuar mundësitë kontrolluese të opozitës. Ajo vetëm në raste të jashtëzakonshme do të arrijë të mbledhë kundër qeverisë shumicën e nevojshme në parlament. Sidoqoftë vetë kritika publike ndaj të metave përkatëse apo kërcënimet në këtë drejtim mund të bëjnë mrekullira.

Opozita parlamentare ushtron ndikim direkt mbi instancën ligjvënëse. Ndryshimet kushtetutese, në kushte normale janë të varura nga pëlqimi i saj. Mirëpo edhe në ligjvënien normale ajo ia del shpesh me ndihmën e partisë qeveritare apo me një krah të saj t’i ndryshoj dukshëm projektligjet e qeverisë. Në këtë rast ajo vepron si avokate e interesave të papërfillura apo të mospërfillura sa duhet dhe kujdeset para së gjithash për një diskutim të lirë dhe të gjerë të vështirësive të ligjvënies. Përveç kësaj, është e mundur që opozita t’i vij në ndihmë qeverisë, nëse ajo duke marrë parasysh kritikën e opozitës, has në rezistencën e kërkesave të njëanshme të partisë së vet.

Me qëllim të funksionimit të suksesshëm, opozitës i duhen të drejtat përkatëse parlamentare. Ajo duhet të jetë e siguar kundër hileve të rregulloreve administrative të shumicës dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme veprimi me qëllim që t’i jipet

mundësia e konstituimit të qeverisë në parlament, e detyrimit të dhënies informacioneve dhe e ushtrimit të kritikës. Para së gjithash, në fushatën zgjedhore, opozita duhet t'i ketë mundësitë e njëjta me partinë qeveritare, të ketë hyrje të njëjtë në mjetet e informimit dhe mundësinë e informimit të lirë të opinionit mbi qëllimet e saj.

Siguria juridike e mundësive të njëjta dhe përcaktimet efektive të mbrojtjes për pakicën në të drejtën parlamentare nuk mjaftojnë vetëm me garantimin e lojës së rregullt në mes qeverisë dhe opozitës mbrenda rendit ekzistues. Të dyja palët duhet të tregojnë ndjenjën e ushtruar tradicionalisht për 'fair play' dhe të respektojnë parimet e stilit politik dhe të procedurës demokratike.

Nuk duhet absolutizuar një model i caktuar i antagonizmit të qeverisë dhe opozitës. Shembulli anglez nuk mund të bartet në çdo sistem partiak dhe qeveritar. Edhe në sistemet shumëpartiake mund të ekzistoj alternativa e institucionalizuar e opozitës parlamentare, si mundësi e një koalicioni tjetër qeveritar në mesin e grupeve parlamentare. Mirëpo këtu, vetëm rrallë vjen deri tek ndërrimi i qartë. Për këtë arsye sistemi shumëpartiak, në kushte normale e ka të vështirëti ndajë në parlament frontet e qeverisë dhe opozitës.

Mirëpo, edhe në shtetet me sisteme dypartiake apo dygrupëshe – në këto të fundit, opozita gjendet kundrejt partisë së madhe qeveritare me partnerë të vegjël, ndërrimi i qeverisë sot është bërë jashtëzakonisht i vështirë. Vendet e opozitës në parlament janë bërë të vështira. Duke kërkuar arsyet e kësaj, me qëllim që mundësitë e opozitës në shtetin e sotëm demokratik të mos vlerësohen në mënyrë të pamatur dhe të gabuar.

3.4 Vështirësitë e opozitës

Dikur vlente thënia 'qeveria shfrytëzon'. Ai i cili ka përjetuar opozitën i është shmangur këtij procesi natyror të shfrytëzimit. Sot, marrja e përgjegjësisë qeveritare duk se ka konsekuenca krejtësisht të tjera. Parashikimi për ardhjen e shpejtë në pushtet të opozitës është zvogëluar dukshëm. Shkaqet për këtë qëndrojnë në mundësitë e rezervuara për sigurim të partisë qeveritare përmes paraplotësimit të interesave duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme. Jo programi zgjedhor por plotësimi i kërkesave të zgjedhësve përmes masave të caktuara dhe të të ashtuquajturave dhurata të zgjedhjes

mund të jetë kushti vendimtar i fitimit të zgjedhjeve. Këtu qëndron njëra ndër pikat e dobëta të sistemit parlamentar. Kritikuesit e saj kryesor dyshojnë se rendi ekzistues akoma ofron dinamikë të mbrendshme dhe gjasa për ndërrim të pushtetit. Për këtë arsye, ata shpesh kërkojnë ndryshime themelore në parakushtet sociale të rendit politik në interes të gjasave të barabarta për të gjithë. Përvoja anglosaksone dëshmon qartë, se ndërrimi i qeverisë dhe i opozitës mbrenda rrethanave ekzistuese pushtetare dhe shoqërore akoma është i mundur. Megjithatë, vigjilenca mbetet: është e rrezikshme për shoqërinë demokratike të vonuar nëse ndaj ngecjeve të grupit dhe shtetit partiak nuk kundërveprohet sa duhet me një mendim të gjallë publik.

Një numër jo i vogël i shoqatave të interesit, në konkurrencën e lirë të forcave, mund t'i drejtohet edhe partisë opozitare, në rast se qeveria mospërfillë rrymat kryesore në mesin e grupeve sociale dhe në mendimin publik. Në rast se partia qeveritare tregon mangësi në dinamikën dhe vullnetin për ndryshim, opozita fiton me këtë rast mundësitë reale për sukses edhe mbrenda rendit ekzistues.

Në të kundërtën përfillja e grupeve të interesit, të afërta me të, e detyron opozitën që të kërkojë bashkëpunim me qeverinë, në mënyrë që të bëjë diçka për klientët e saj. Kjo mund të sjellë lehtë deri tek konsekuenca, që opozita, në këtë bashkëpunim, ta lë pasdore rolin e kontrollit. Duhet ruajtur trendi në një shoqëri, sipas të cilit, qytetari është i interesuar në mënyrë primare për sigurinë e tij sociale. Mundësitë për bashkëndikim bëhen më të rëndësishme se sa pesha e opozitës.

Kësaj i bashkangjitet edhe një element tjetër. Kompleksiteti i gjendjes faktike ligjvënëse kërkon njohuri shumë të mëdha mbi realitetin dhe informata të klasit të parë. Përmes burokracisë shtetërore, partia qeveritare e ka lehtë t'i sigurojë ato. Në kushte normale, opozita nuk ka hyrje në to. Për këtë arsye ajo ka pak mundësi të paraqes projektligje të veta apo të zhvillojë alternativa ndaj projekteve të qeverisë.

3.5 Opozita në shtetin demokratik

Angazhimi politik në shtetin social modern liridashës kërkon një klimë të moderuar politike. Aftësia e treguar për përfundimin e plotësishëm të kontradiktave politike parashikon konsensusin në vlerat themelore politike, marrëveshjen mbi të pavotueshmen. Demokracia moderne mundëson modele të ndryshme, përkundër

detyrimeve objektive të botës teknike. Në të ekzistojnë rradhitje të ndryshme në urgjencën e masave politike dhe shpesh edhe mënyra të ndryshme të realizimit të një qëllimi politik të pranuar nga të gjithë. Për opozitën mbetet në këtë mënyrë mjaftë hapësirë profilizimi brenda rendit ekzistues, veçanërisht atëherë kur ajo ushtron kritikë. Demokracia ka nevojë për opozitë legale brenda dhe jashtë parlamentit, ndikimi dhe disiplina e së cilës janë kriter vendimtar i liridashjes dhe tolerancës së një shoqërie. Vetëm në ekzistencën e tensionuar me dhe pranë njëra – tjetrës të qeverisë dhe opozitës shpaloset politika demokratike.

Opozita ka nevojë për guxim dhe fantazi, por edhe për një atmosferë në shoqëri, e cila pohon diskutimin politik dhe nuk e vlerëson atë si diçka negative. Ajo ka nevojë për një atmosferë të tillë politike, e cila nuk i jep parimisht epërsi qeverisë për shkak të besueshmërisë së gabuar të autoritetit apo që e dënon kritikën si shpërbërje. Ajo ka nevojë për hapje të mëtejshme për perspektiva të reja dhe transformim social, gatishmëria për ndryshime personale në kryesi, si mundësi për impulse shoqërore dhe shtetërore. Në këtë kontekst opozita është e varur nga gjendja e mendimit publik. Një publik i sigurtë në vete dhe kritik është ndihma më e madhe për opozitën, e cila nga ana vë theks të veçantë në opinionin politik të një vendi, i cili mund ta bëjë forcë krijuese të demokracisë moderne.

3.6 Ndarja e opozitës

Varësisht nga roli dhe mënyra e veprimit të opozitës në parlament, opozita ndahet në dy grupe kryesore¹³:

1. Opozitë konstruktive
2. Opozitë destruktive
1. Opozitë konstruktive konsiderohet ajo që kritikon programin e partisë apo koalicionit qeverisës në mënyrë dhe me mjete parlamentare, pra duke kërkuar modifikim, realizimin dhe avansimin e programit qeverisës e duke propozuar programet e tyre alternative.

¹³ Arsim Bajrami, Teoria dhe Praktika Parlamentare, Flaka:Shkup, 2002, fq. 165

Përkundër kësaj, opozita destruktive vetëm kritikon veprimet e partisë apo koalicionit qeverisës duke mos ofruar zgjidhje konkrete. Ky lloj i opozitës, përpiket edhe për rrëximin e dhunshëm të qeverisë dhe shpalljene zgjedhjeve të parakohshme apo të jashtëzakonshme.

Kapitulli i peste

I Krizat parlamentare në R e Maqedonisë

1. Konteksti i tranzicionit demokratik në Maqedoni

Procesi i tranzicionit demokratik të Maqedonisë nis me tranzicionin demokratik të vendeve të Europës Lindore, përkatësisht të Europës Juglindore si një kontekst më i gjerë gjeopolitik dhe kohor i tranzicionit pas shembjes së Murit të Berlinit, dhe në kontekstin më të ngushtë gjeopolitik të tij, periodën e nisjes dhe mbarimit të shpërbërjes së RSFJ-së, pjesë integrale e së cilës ishte¹⁴. Ky kontekst ka kushtëzuar edhe tipin e tranzicionit të saj demokratik, prandaj edhe trajektorja e tranzicionit të saj ndjek më parë karakteristikat, analogjitë, kontradiktat dhe paradokset e këtij tranzicioni të përgjithshëm në rrafsh gjeopolitik të Europës Lindore, mandej të vendeve, gjegjësisht të republikave që u mëvetësuan në shtete kombëtare nga shpërbërja e Federatës jugosllave.

Ndonëse në vija të përgjithshme tranzicioni demokratik në Maqedoni ndjek vijat kryesore globale të këtij konteksti tranzicional, ky, megjithatë, do të përgjithësojë edhe një vulë të veten me disa elemente të tij, një rrugë të veten, të diktuar nga rrethanat politike endogjene të vendit. Pikërisht, ana e vecantë e këtij tranzicioni në Maqedoni, sipas Sllavko Millosllavevskit¹⁵ do të jenë paradokset që e përshkuan atë në fazat e para të fillimeve, por që determinuan, pastaj, edhe udhën e mëvonshme të tij në rrafshin politik e konstitucional në Maqedoni.

Në karakteristikat e tij të përgjithshme, tranzicioni demokratik në Maqedoni, lidhur ngushtë me kontekstin gjeopolitik në të cilin u zhvillua, s'kishte se si të mos ishte, si

¹⁴ Shih Kushtetutën e RSFJ-së 1974, RSM ishte njisi federale e RSFJ bashkë me pesë republika tjera dhe dy krahina autonome.

¹⁵ Slavko Molloslavevski – “Makedonski kontraverzi”, Skopje-2004

gjithë tranzicionet e vendeve të tjera që bëjnë pjesë në këtë kontekst, si një tranzicion i trefishtë, gjegjësisht, tredimensional: si një tranzicion politik, social, ekonomik dhe konstitucional.

Tranzicioni demokratik në Maqedoni që bën pjesë në tipin e tranzicioneve të qeta nga lart-poshtë, sipas tipologjisë së bërë nga tranzitologët, do të ndjekë një dinamikë politike të përcaktuar, përvijuar nga vendimet strategjike të aktorëve të këtij tranzicioni të saj. Së këndejmi, është fare e kuptueshme se trajektorja e tij, nga faza nismëtare dhe vecanërisht në këtë fazë dhe gjer pak më vonë para konfliktit të vitit 2001, ka mbajtur vijën e kësaj strategjie që e aplikuan me sens të thellë politik aktorët e saj.

Strategjia e tranzicionit demokratik e aktorëve politikë maqedonas, kur shikohet tash pas një kohe të mbarimit të tij, del se ka patur vërtet një veçanësi të veten, autentike, që e veçon nga tranzicionet e vendeve të tjera ish-komuniste të rajonit, e dirigjuar me vëmendje nga aktorët e saj që kanë ditur ta mbanë me manovrat politike pa u tronditur thellë, pa u përmbysur një kohë nga turbulencat politike rajonale që turbulluan rrjedhat e tranzicionit në disa vende, si në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Serbi dhe në disa vende të Europës Lindore.

Megjithatë, në konfliktin e vitit 2001, edhe pse në një formë edhe jo aq drastike, tranzicioni demokratik në Maqedoni nuk do të shpëtojë pa e kthyer konfliktin politik të nxitur nga pakënaqësia e thellë e shqiptarëve me statusin politik-juridik na shtetin e ri, në konflikt kushtetues. Në fakt, konflikti shqiptaro-maqedonas, që nga faza initiale e tranzicionit dhe në prak të vitit 2001 manifestohet politikisht si një konflikt kushtetues latent, por nga establishmenti politik e shtetëror maqedonas është mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm dhe, duke i besuar shkallës së këtij kontrolli të vënë mbi jetën politike të shqiptarëve dhe aktorëve të saj, nuk e kanë parë të besuar se mund të shkallëzohet në konflikt të hapur dhe jopolitik, por luftarak për zgjerimin e të drejtave kushtetuese të shqiptarëve.

Shikuar në këtë aspekt, konflikti i vitit 2001 e fut Maqedoninë në radhën e shteteve që dolën më vete nga shpërbërja e RSFJ-së, vecanërisht Kroacia e Bosnja Hercegovina, Serbia dhe në të cilat konfliktet politike në thelb ishin konflikte kushtetuese që trazuan konfliktet luftarake si konflikte teritoriale ndërmjet tyre dhe brenda tyre.

Konflikti në Maqedoni, duke mos u nisur si konflikt luftarak territorial, u imponua thjesht si konflikt për të drejta kushtetuese, pra u imponua si forcë luftarake për ndryshim të Kushtetutës së vitit 1991¹⁶, e cila e gjeneroi pakënaqësinë politike, gjegjësisht konfliktin politik shqiptaro-maqedonas. Edhe në këtë aspekt, konflikti i vitit 2001, shikuar në kontekstin e konflikteve të tjera që shpërthyen në rajon, ka të veçantën e vet dhe që bën një ndërhyrje gati në fazën e fundit të tranzicionit në maqedoni, për të ndrequr në disa vija bazën e shtrembër që aktorët politikë të tranzicionit demokratik në Maqedoni i vunë në fazën initiale të tij kur bënë ridefinimin e konceptit të ri shtetëror mbi baza të vjetëruara, duke imponuar njëanshëm konstituimin e shtetit të tyre kombëtar mbi konceptin e shtetformësisë etnocentrike dhe rrjedhimisht edhe të demokracisë etnike, të mbuluar me një fasadë të rreme me diskursin juridik-kushtetues si shtetformësi qytetaro-demokratike, me pretendime për ta mbrojtur e legjitimuar me kokëfortësi të pathemeltë konstituimin e Maqedonisë si bashkësi politike moderne mbi bazë të konceptit parlamentarodemokratik.

2. Ndarja dhe ballansi i legjislativit dhe egzekutivit në Maqedoni

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e nxjerrë më vitin 1991, e definon Maqedoninë si / *shtet sovran, të pavarur, demokratik dhe social*¹⁷ në të cilin sovraniteti buron nga qytetarët dhe atyre u takon. Republika e Maqedonisë është shtet unitar dhe me *demokraci parlamentare*, si vlera bazike të rendit të saj kushtetues.

Pushteti shtetëror ushtrohet nga organet e ndara të pushtetit: *ligjvënës, ekzekutiv dhe të judikaturës*. Pushteti ligjvënës i takon Kuvendit, i cili është njëdhëmoeësh, i përbërë nga 120 gjer në 140 deputetë të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të lira e të drejtpërdrejta dhe me mandat katërvjecar.

Kushtetuta e vitit 1991, që në fakt duhet të konsiderohet si kushtetutë e parë e saj si shtet i pavarur, sanksionoi një model paksa të hibridizuar të demokracisë

¹⁶ Zemri Elezi “Kontrolli parlamentar i qeverisë me vështrim të veçantë në RM periudha 1990-2000”, Prishtinë-2002.

¹⁷ Kushtetuta e RM, 1991. “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 52/1991, më 22 nëntor të vitit 1991.

parlamentare: ky model përmban ca elemente të sistemit palamentar, ca elemente të sistemit presidencial dhe ca nga ai kuvendor. Një autor maqedonas i së drejtës kushtetuese, Svetomir Shkariq¹⁸, këtë model e cilëson si *>sistem parlamentar/presidencial, gjegjësisht si një sistem i përzier, i përshtatur me specifikat shoqërore të Maqedonisë>*. Një tjetër autor, S.Millosavlevski²⁰⁰⁴ këtë model e cilëson si *>sistem parlamentar me elemente të zbutura të sistemit presidencial*.

Megjithatë, në praktikë, demokracia parlamentare në Maqedoni u zbatua në formën e saj konfuze-me praktikën e sistemit kuvendor më tepër se sa parlamentare apo gjysmëpresidenciale, si u cilësua nga autorët vendas apo si po cilësohet sot e kësaj dite nga konstitucionalistët e huaj. Në fakt, Kushtetuta e 91-shit njeh parimin themelor të parlamentarizmit-përgjegjësinë e qeverisë para parlamentit, që don të thotë që qeveria duhet vazhdimisht gjatë mandatit të saj të gëzojë besimin e Parlamentit, por nuk parasheh mundësinë e qeverisë për të shpërndarë parlamentin, në një kontekst parlamentar ku parlamenti mund të rrëzojë qeverinë. Me këtë është hequr mundësia e veprimit reciprok në dispozicion të qeverisë dhe parlamentit që do të garantonte një bashkëpunim të ekuilibruar ndërmjet këtyre dy institucioneve.

S.Milloslavlevski¹⁹(2004) me këtë rast konstaton se Kushtetuta e 91-shit në këtë aspekt përmban një "dobësi strukturore" që duhet hequr në ndryshimet kushtetuese të ardhme me futjen e të drejtës së qeverisë për të shpërndarë parlamentin në raste të fundit të zgjidhjes së krizës qeveritare të ndodhur.

Qeveria e Maqedonisë disponon, ndërkaq, të tjera mjete të veprimit ndaj Parlamentit, sikundër janë-nisma ligjore, caktimi i rendit të ditës së parlamentit, ose e drejta e ministrave për të asistuar në mbledhjet parlamentare.

¹⁸ Shih Svetomir Shkariq 'Ustavno pravo-II'-Shkup-2005

¹⁹ Slavko Milosavlevski 'Makedonski kontraverzi' 2004,Shkup.

3. Marrëdhënjet e Kuvendit me kryetarin e Republikës së Maqedonisë dhe me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, organizimin e pushtetit shtetërorë e bazon në parimin e ndarjes së pushtetit në ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësorë²⁰. Për sejcilin prej këtyre funksioneve egzistojnë organe të posaçme të cilë më tepër ose më pak janë të mëvehtësisë dhe të pamvarur në ushtrimin e kompetencave të tyre. Kushtetuta në esencë bënë kufizimin e kompetencave të organeve shtetërore dhe në atë mënyrë formalisht siguron që pushteti ligjdhënës të mos i mer kompetencat e pushtetit ekzekutiv dhe e kundërta. Megjithatë, njëkohësisht në Kushtetutë parashihen edhe shumë mekanizma të bashkpunimit të ndërsjellë, ndikim dhe kontrollë ndërmjet mbartësve të pushtetit me çka sigurohet baraspesha dhe nuk mundësohet subordinimi i një organi ndaj tjetrit, gjegjësisht një organ ta merr krejt pushtetin dhe funksionet e tyti ushtroj jashta sistemit. Në ato korniza vendosen edhe raportet e Kuvendit me Kryetarin e Republikës dhe Qeverinë.

4. Raportet mes Parlamentit dhe Qeverisë

Kryetari i Republikës, si një ndër bartësit e pushtetit ekzekutiv, është i pamvarur dhe i m'vhtësishëm në ushtrimin e kompetencave të tij të përcaktuara me Kushtetutë.

M'vhtësia dhe pamvarësia e pozicionit të tij del edhe nga fakti se Kryetari i Republikës legjitimitetin e tij e fitonë drejtpërdrejtë prej qytetarëve në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me vota të fshehta. Megjithatë, Kushtetuta parashihet instrumete me të cilët vendosen raporte të bashkpunimit dhe ndikim reciprok të Kryetarit të Republikës si organ i pushtetit ekzekutiv dhe Kuvendit si organ i pushtetit ligjdhënës.

Kryetari i Republikës sëpaku njëher në vitë e informon Kuvendin për çështje nga kompetencat e veta²¹. Informimi që ja bënë Kryetari i Republikës, Kuvendit, është në suaza të kompetencave kushtetuese të Kryetarit dhe paraqitja e tij para Kuvendit ka

²⁰ Z. Elezi 'Ndarja, ekuilibrimi dhe bilanci i tre pushteteve, bazë e demokracisë parlamentare', Prishtinë-2001.

²¹ Shih nenin 85 të Kushtetutës së RM-së.

të bëjë veçanërishtë me realizimin e politikës ndërkombëtare të shtetit, mbrojtjes, çështjet lidhur me sovranitetin, integritetin dhe sigurinë e vendit. Paraqitja e Kryetarit të Republikës para Kuvendit nuk nënkupton përgjegjësi dhe raport për punën e tijë për çka Kuvendi nuk duhet të hapë debat reth informatës së Kryetarit. Megjithatë, ky prezentim i Kryetarit para Kuvendit, është shumë me rëndësi si për Kuvendin ashtu edhe për opinionin e gjërë përmes së cilës informohen për qëndrimet dhe mendimet e Kryetarit për pozicionin ndërkombëtar si dhe stabilitetin e mbrendshëm dhe të jashtëm të vendit. Duke patur parasysh autoritetin e funksionit, paraqitja e Kryetarit padyshim kontribon në objektivat e politikës globale dhe në orjentimet e Kuvendit në ushtrimin e kompetencave të tijë.

Mundësija kushtetuese e Kuvendit që të kërkojë prej Kryetarit të Republikës mendim për çështje nga kompetencat e tijë, gjithashtu, paraqet mekanizëm për vendosjen e raporteve reciproke direkte në mes Kryetarit dhe Kuvendit.

Kryetari Republikës dhe Kryetari i Kuvendit i nënshkruajnë dekretin për shpalljen e ligjeve²² që është kusht që ligjet të mund të shpallen në gazetën zyrtare dhe të hyjnë në fuqijë. Kryetari i Republikës munt të ndodh që të mos e nënshkruaj dekretin. Në atë rast Kuvendi përsëri e shqyron ligjin dhe poqese e miraton me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Kryetari i Republikës është i obliguar ta nënshkruaj.

Kjo e drejtë e Kryetarit të Republikës nuk është e drejtë absolute e vetos por veto suspensive, ngase me mosnënshkrimin e shpalljes Kryetari nuk e heq nga procedura sjelljen e ligjit por përkohësisht e shtynë sjelljen e tijë gjegjësishtë hyrjen në fuqi të tijë. Edhe pse me veprim të kufizuar, kjo e drejtë i mundson Kryetarit të ndikoj në procesin ligjdhënës, gjegjësishtë në formësimin pëfundimtarë të zgjidhjeve në ligje. Vetoja suspensive paraqet “filter” adekvatë për shmangjen e mospajtimeve eventuale të ligjit të miratuar me sistemin kushtetues dhe politiko-ekonomikë, para shpalljes së tijë.

Kryetari i Republikës si një ndër propozuesit që të inicoj ndryshimin e Kushtetutës, me përcaktim të parimeve përcaktuese për kreimin e Kushtetutës si akt më i lartë

²² Shih nenin 75 të Kushtetutës së RM-së.

juridiko-politik i shtetit, garanton ndikim në realizimin edhe të funksionit kushtetutëdhënës të Kuvendit.

Në mes Kryetarit të Republikës dhe Kuvendit, vendosen marrëdhënje edhe kur Kryetari paraqitet në cilsi të propozuesit të akteve që i sjellë Kuvendi. Ngase, Kryetari përveç Qeverisë dhe më së paku 40 deputet, mund të japë propozim për hyrje ose dalje në federatë ose bashkësi me shtete tjera dhe propozim për hyrje dhe dalje në antarsimin në organizatat ndërkombëtare. Poashtu, Kryetari mund të propozoj që Kuvendi të sjellë vendim për shpalljen e luftës dhe gjengjes së jashtzakonshme nën kushtet e përcaktuara me Kushtetutë.

Kryetari i Republikës është Kryetar i Këshillit të sigurimit i cili është institucion shumë i rëndësishëm kushtetues, i cili i shqyrton çështje lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit dhe përmes dhënjes së propozimeve ushtron ndikim të rëndësishëm ndaj Kuvendit kur ai debaton për çështje lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Kryetari i Republikës propozon dy gjykatës në Gjykatën kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, dy anëtarë në Këshillin Gjyqësorë Republikan²³. Pas kësaj, Kuvendi nuk ka mundësi të bëjë vlersimin e kandidatëve të propozuar as që të bëjë ndryshimin e propozimeve, ndërsa mospajtueshmërinë eventuale për kandidatët e propozuar mund ta shprehe vetëm përmes votimit.

Në marrëdhënjet e përgjithshme të vendosura në mes Kryetarit të Republikës dhe Kuvendit, është më se e domosdoshme të theksohet edhe çështja lidhur me zëvendësimin e Kryetarit të Republikës. Kushtetuta i ndanë rastet kur Kryetari i Kuvendit e ushtron funksionin e Kryetarit të Republikës, prej rasteve kur Kryetari i Kuvendit e zëvendëson Kryetarin e Republikës në ushtrimin e funksioneve të tij.²⁴

Kryetari i Republikës zgjidhet përmes zgjedhjeve të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, legjitimitetin e fiton direkt prej qytetarëve dhe formalisht tyre ju përgjigjet, e jo Kuvendit. Megjithatë, Kushtetuta parasheh mekanizma për ndikim të drejtpërdrejtë të Kuvendit ndaj Kryetarit të Republikës me çka i pamundësohet

²³ Shih nenin 84 të Kushtetutës së RM-së.

²⁴ Në lidhje me këtë çështje u deklarua edhe Gjykata kushtetuese e Republikës së Maqedonisë. (Vendimi i Gjykatës kushtetuese "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/98).

Kryetarit ti ushtroj funksionet e tija , jashta pozicionit të tijë të përcaktuar me Kushtetutë. Ngase, edhe pse Kryetari nuk përgjigjet para Kuvendit, Kuvendi mundet para Gjykatës Kushtetuese të inicoj procedurë për konstatimin e përgjegjësisë së tijë, kur do të vlersoj se Kryetari i ka thyer ligjet dhe Kushtetutën. Kjo dëshmon se Kuvendi është në pozicion ti vlersoj vendimet dhe sjelljet e Kryetarit të Republikës.

Mirpo Kushtetuta parasheh kushtet të vështira për iniciimin e kësaj procedure (shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve a vendimin përfundimtar e sjell Gjykata Kushtetuese), me çka pamundsohet Kuvendi ta “keqpërdori” këtë të drejtë kushtetuese dhe pabazë ta bie në pyetje autoritetin e Kryetarit të Republikës.

Kryetari i Republikës si pjesë e pushtetit ekzekutiv ka ingjirencë të konsiderueshme në zbatimin e politikës së jashtme të Republikës në lidhjen e marrëveshjeve ndërkombtare. Kuvendi ka mundsi të ndikoj në ushtrimin e këtij funksioni të Kryetarit, me atë se Kuvendi i ratifikon marrëveshjet që Kryetari i ka lidhë. Gjithashtu, nuk përjashtohet mundësia që Kuvendi ta refuzoj ratifikim e marrëveshjes ndërkombëtare që e ka lidh Kryetari, për çka Kryetari është i detyruar të mbaj llogari për qëndrimet dhe mendimet e Kuvendit në aspekt të politikës së jashtme²⁵.

Marëdhënjet midis Kuvendit dhe Qeverisë, po ashtu, janë të rregulluar në bazë të principit të ndarjes së pushtetit, por në realizimin e funksionit ligjdhënës dhe ekzekutiv egzistojnë relacione të ndërsjelta të bashkpunimit dhe ndikimit, pa u sjell në pyetje çështja e m’vetësisë dhe pamvarsisë të këtyre organeve e përcaktuar me kushtetutë.

Qeveria, sipas Kushtetutës është mbartës i pushtetit ekzekutiv të Republikës dhe është organ i pamvarur republikan i cili funksionet e saja i kryen në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo m’vehtësi e Qeverisë i sigurohet me ndarjen e funksioneve të Qeverisë ndaj mbartësve tjerë të pushtetit, ku Qeverisë i sigurohet “monopol” në përcaktimin e politikës së ekzekutimit të ligjeve dhe dispozitave tjera që i sjellë Kuvendi.

Nji ndër elementet më të rëndësishëm të ndikimit direkt të pushtetit legjislativ ndaj aty ekzekutiv është se Kuvendi e zgjedh Qeverinë dhe ajo ka përgjegjësi politike para

²⁵ Shih nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Kuvendit. Qeverija mandatin e saj e fiton (besimin) prej Kuvendit i cili është në pozicion çdo her kur të velersoj se për atë ka arsye mund tja mer mandatin Qeverisë. Në Kushtetutë decidivisht është përcaktuar se Kuvendi ushtron kontroll politik dhe mbikqyrje ndaj Qeverisë dhe janë parapa mekanizmat e kontrollit të cilë mund të sjellin deri te efektuimi i përgjigjesisë politike. Përgjigjësia politike shprehet si përgjegjësi solidare-kolektive e Qeverisë në tërësi edhe si përgjegjësi individuale për secilin ministër individualisht me atë që përgjegjësjë kolektive realizohet përmes institutit të votimit për besimin e Qeverisë ndërsa përgjigjësia individuale përmes institutit shkarkimin e ministrit të caktuar²⁶. Egzistimi i kontrollit politik para Kuvendit e imponon nevojën që puna e Qeverisë në tërësi dhe e ministrave individualisht të jetë në pajtueshmëri me qëndrimet e shumicës në Kuvend, me çka vërtetohet besimi. Poqëse besimi mungon nga cila do arsye, atëherë ato thihen në përgjegjësi politike, kshuqë Qeverija të cilës i është votuar mosbesimi, është e obliguar të japë dorheqje me çka i pushon funksioni.

Edhe pse Qeverija nuk ka autorizime kushtetuese të sjellë ligje, përsëri mund të ndikoj në realizim e veprimtarisë ligjdhënëse të Kuvendit përmes së drejtës së paraparë me Kushtetutë të propozoj ligje, Byxhetin Republikan dhe dispozita tjera që i sjellë Kuvendi. Qeverija në këtë rastë paraqitet në rolin e propozuesit të autorizuar së bashku me deputetët. Në këtë kuptim duhet theksuar edhe e drejtat kushtetuese e Qeverisë që të japë mendime për ligjet e propozuara Kuvendit nga propozuesit tjerë. Qeverija në pajtim me Kushtetutën është një ndër propozuesit e autorizuar për ndrihimin e Kushtetutës së Republikë së Maqedonisë.²⁷

5. Kontrolli parlamentar i qeverisë në Maqedoni

Për të bërë një analizë krizave institucionale përkatësishtë asaj parlamentare dhe qeveritare në Republikën e Maqedonisë në periudhën kohore 1991-2006²⁸, patjetër duhet të bëjmë një vështrim pragmatik zgjedhjeve parlamentare në të gjitha mandatet

²⁶ Shih 'Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit të RM', Zhivko Todoroski, Shkup-2000.

²⁷ Realizimi i marrëdhënjëve të përcaktuara me Kushtetutë në mes Kuvendit dhe Qeverisë më detalisht janë përpunuar në pjesën e publikimit për procedurë e sjelljes së ligjeve dhe rrealizimi i kontrollit politik të Kuvendit ndaj Qeverisë.

²⁸ 'Kontrolli parlamentar i Qeverisë në RM në periudhën 1990-2000', Z. Elezi, Prishtinë, 2001.

parlamentare të kësaj periudhe si dhe zgjedhjen e Qeverisë dhe pozicionet e saja në Parlamentin e Maqedonisë.

Në R.M., në periudhën 1991-2016 në të gjitha zgjedhjet parlamentare asnjë parti politike nuk ka fituar shumicën në parlament. Numri i partive politike të cilat garonin në zgjedhjet parlamentare (19 parti politike në zgjedhjet parlamentare të 1990; 38 më 1994; 38 më 1998; 31 më 2002 si dhe 29 më 2006), dhe të gjitha këto parti politike që bëheshin pjesë e parlamentit asnjëra nuk mundej që në mënyrë autonome të formojë qeverinë e saj partiake dhe patjetër imponohej nevoja e koalicionimeve të partive politike për të formuar qeveri koalicionuese. Kjo dëshmon qartë se në RM ende nuk është bërë diferencimi i qartë partiak, që gjithsesi është karakteristikë e vendit që deri më vitin 1991 kishte sistem një partiak.

Maqedonia pas pavarësimit të saj në vitin 1991 ka miratuar Kushtetutën e saj me të cilën ka sanksionuar sistemin parlamentar si bazë të qeverisjes shtetërore. Ky system i qeverisjes bazohet në parimin e ndarjes së pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushteti legjislativ i është besuar Kuvendit të Maqedonisë, ai ekzekutiv Qeverisë, kurse pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e pavarura. Kjo ndarje e pushteteve bënë pjesë në të ashtuqujturën “ndarje e butë” e pushteteve sepse lejon ndërhyrje të një pushteti në tjetrin. Megjithatë balansi dhe ekuilibri midis legjislativit dhe ekzekutivit bazohet në prioritetin e parlamentit dhe në kontrollin politik që ai i bënë qeverisë. Ky prioritet legjislativ është pasojë e zbatimit të sistemit monocefal ekzekutiv në të cilin bartës kryesor i pushtetit ekzekutiv është Qeveria, e cila nuk ndan këtë funksion me Presidentin ndaj të cilit nuk jep llogari politike.

Marrëdhëniet midis Kuvendit dhe Qeverisë - po ashtu, janë të rregulluar në bazë të principit të ndarjes së pushtetit, por në realizimin e funksionit ligjdhënës dhe ekzekutiv ekzistojnë relacione të ndërsjella të bashkëpunimit dhe ndikimit, pa u sjell në pyetje çështja e mëvetësisë dhe pavarësisë së këtyre organeve e përcaktuar me kushtetutë.

Qeveria, sipas Kushtetutës është mbartës i pushtetit ekzekutiv të Republikës dhe është organ i pavarur republikan, i cili funksionet e tij i kryen në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo mëvetësi e Qeverisë i sigurohet me ndarjen e funksioneve të Qeverisë

ndaj mbartësve tjerë të pushtetit, ku Qeverisë i sigurohet "monopol" në përcaktimin e politikës së ekzekutimit të ligjeve dhe dispozitave tjera që i sjellë Kuvendi.

Një ndër elementet më të rëndësishëm të ndikimit direkt të pushtetit legjislativ ndaj aty ekzekutiv është se Kuvendi e zgjedh Qeverinë dhe ajo ka përgjegjësi politike para Kuvendit. Qeveria mandatin e saj e fiton (besimin) prej Kuvendit i cili është në pozicion çdo herë kur të vlerësojë se për atë ka arsye mund t'ia merr mandatin Qeverisë.

Në Kushtetutë decidivisht është përcaktuar se Kuvendi ushtron kontroll politik dhe mbikëqyrje ndaj Qeverisë dhe janë parapa mekanizmat e kontrollit, të cilat mund të sjellin deri te efektuimi i përgjegjësisë politike. Përgjegjësia politike shprehet si përgjegjësi solidare-kolektive e Qeverisë në tërësi edhe si përgjegjësi individuale për secilin ministër individualisht me atë që përgjegjësia kolektive realizohet përmes institutit të votimit për besimin e Qeverisë ndërsa përgjegjësia individuale përmes institutit shkarkimin e ministrit të caktuar. Ekzistimi i kontrollit politik para Kuvendit e imponon nevojë që puna e Qeverisë në tërësi dhe e ministrave individualisht të jetë në pajtueshmëri me qëndrimet e shumicës në Kuvend, me çka vërtetohet besimi. Poqëse besimi mungon nga cila do arsye, atëherë ato thirren në përgjegjësi politike, kështu që Qeveria të cilës i është votuar mosbesimi, është e obliguar të japë dorëheqje me çka i pushon funksioni.

Me realizimin e kontrollit politik nga ana e Kuvendit, kontrollohen dhe konstatohen gjendjet në lëmitë e caktuara për të cilat është kompetente Qeveria në tërësi respektivisht në përkujdesjen e zbatimit të tyre ndërsa zbatimi i drejtpërdrejtë bëhet përmes organeve të administratës shtetërore gjegjësisht ministrive. Në rastet e konstatimeve të dukurive negative dhe të tejkalimeve në punën e tyre, Kuvendi i aktivizon mekanizmat e tij për mes të cilave ushtron kontrollin politik që për pasojat shqipton sanksionet politike, edhe atë: votimin e mosbesimit të Qeverisë gjegjësisht shkarkimin e anëtarit të Qeverisë ose mbartësin e funksioneve publike. Me realizimin e funksionit të kontrollit politik të Kuvendit, zbatohet në tërësi parimi i garantimit të punës publike dhe ligjore të ekzekutivit. Si mekanizma kryesorë për ushtrimin e kontrollit politik të Kuvendit ndaj punës së Qeverisë, anë:pyetjet e

deputetëve, interpelanca parlamentare, komisionet anketuese parlamentare dhe çështja e votëbesimit të Qeverisë.

6. Skaqet dhe pasojat e krizave parlamentare ne Maqedoni

Në Republika e Maqedonisë pas pavarësisë së saj ka filluar ndertimin e demokracisë parlamentare të bazuar në sistemin shumëpartiak dhe përpjekjet e shtetndërtimit të Maqedonisë në mes opcionit të një shteti etnocentrik dhe shteti unitar multietnik. Në këtë kontekst në Maqedoni krizat parlamentare janë shfaqura kryesisht si kriza politike kryesisht në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve në dimensionin e shtetndërtimit të Maqedonisë²⁹ si dhe në procesin e formimit të qeverive dhe stabilitetit të koalicioneve parlamentare dhe qeveritare

Poashtu në Maqedoni si gjenerator i krizave politike dhe parlamentare, paraqiteshte edhe vet Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1991. Kjo kushtetutë shkaktonte shpesh herë edhe kriza politike në aspektin e marrëdhënieve ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve e cila kulminacionin e saj e ariti me konfliktin e 2001. Në fillim të vitit 2001 në Maqedoni shpërtheu konflikti i armatosur mes forcave të armatosura dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila kërkonte avancimin e të drejtave të shqiptarëve në vend. Konflikti përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit³⁰ në gusht të po të njëjtit vit, e cila parashihte avancimin e të drejtave të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera etnike në Maqedoni (turqit, boshnjakët, serbët, vllahët dhe romët), dhe rezultoi me ndryshimet kushtetuese- 15 amendamentet kushtetuese , të cilat e shëndruan Maqedonin nga një shtet unitar etnocentrik në shtet unitar multietnik.

Që nga pavarësia e deri më sot, Maqedonia ka kaluar nëpër disa kriza politike, në mesin e tyre, më e madhja dhe më e rëndësishmja nga pavarësia konsiderohet kriza politike që u thellua në vitin 2015, e cila nga krizë politike, u shndërrua në krizë institucionale dhe më pas edhe në krizë të sigurisë.

²⁹ Elezi, Z., 2015. **Constitutional agreement basic to functioning of multiethnic states**. Craiova, Romania, The Center of Post-Communist Political Studies (CEPOS)

³⁰ **Marrëveshja e Ohrit**, Shkup, Gusht 2001

Kriza politike në fjalë u thellua edhe pas negociatave të liderëve të dy partive më të mëdha politike, kryetarit të VMRO-DPMNE-së dhe kryeministrit të atëhershëm Nikolla Gruevski dhe liderit të Lidhjes Social Demokrate të Maqedonisë (LSDM), Zoran Zaev, kryeministrit aktual. Ajo filloi me publikimin e disa audiomaterialeve kompromentuese, të ashtuquajturat “bomba”, të cilat te qytetarët shkaktuan zemërim, ndërsa u organizuan protesta në kryeqytetin e vendit, Shkup dhe në të gjithë Maqedoninë. Jashtë ndërtesës së qeverisë në Shkup, qytetarët ngritën tenda dhe kërkuan dorëheqjen nga qeveria e udhëhequr nga Nikolla Gruevski. Kjo çoi në negociata midis palëve me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe në arritjen e Marrëveshjes së Përzhinës, e cila parashihte tejkalimin e krizës politike dhe mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare që u realizuan më 11 dhjetor të vitit të kaluar, të cilat ishin zgjedhjet e nënta parlamentare që nga pavarësia e shtetit dhe zgjedhjet e katërta të parakohshme parlamentare. Pas zgjedhjeve parlamentare, në prill u zgjodh kryetari i ri i Kuvendit në rrethana të tensionuara, ku një grup i demonstruesve që protestonin kundër zgjedhjes së Talat Xhaferi si kryetar i parlamentit hyri në ndërtesën e kuvendit dhe shkaktuan incidente, me çka u lënduan deputetë dhe gazetarë. Më 1 qershor 2017, qeveria e re e Republikës së Maqedonisë filloi punën, e udhëhequr nga lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, e cila është zotuar për të përmbushur reforma urgjente për përshpejtimin e pranimin të vendit në strukturat euroatlantike.

II Rast studimi krizave parlamentare ne Maqedoni

RASTI I I-rë

Në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Republikës Socialiste të Maqedonisë e mbajtur me 19 janarë të vitit 1991 e në baze të Vendimit për zgjedhjen dhe shkarkimin të Kryetarit të Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe të Nënkyetrarit të Kryetarit të Republikës Socialiste të Maqedonisë³¹ një grup prej 22 deputetësh të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë- Partisë për Rindërtim Demokratik parashtrojnë propozim deri te Komisioni për emërime dhe zgjedhje të Kuvendit. Komisioni parashtron propozim për z. Kiro Gligorov për Kryetar të Rpublikës Socialiste të Maqedonisë.

Votimi është mbajtur me vota të mshehta. Në sajë të raportit të Komisionit për votim konstatohet me sa vijon:

Gjithsej votojnë 120 deputetë për kandidatin z. Kiro Gligorov votojnë 60 deputet ndërsa 60 fletëvotuese janë të pavlefshme.

Në bazë të rezultateve nga votimi, Kryetari i Kuvendit shpallën se kandidati Kiro Gligorov nuk është zgjedhur për Kryetar të Republikës Socialiste të Maqedonise, mbasi nuk i fitoi 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të parlamentit.

Në sëancën e 5 të Kuvendit të Republikës Socilaiste të Maqedonisë e mbajtur me datë 27.01.1991 një grup prej 55 deputetësh³² propozon z. Kiro Gligorov si kandidat të mundshëm për Kryetar të Republikës Socilaiste të Maqedonisë.

Komisioni për emërime dhe zgjedhje në bazë të këtij propozimi përpilon listën e kandidatit për Kryetar të Republikës Socialiste të Maqedonisë. Zgjedhja bëhet me vota të fshehta. Nga rraporti i Komisionit për votim konstatohet se gjithësejt votojnë 119 deputet nga të cilët për kandidatin Kiro Gligorov votojnë 114 deputet ndërsa 5 fletëvotime janë të pavlefshme. Në bazë të rezultateve të votimit Kryetari i Kuvendit shpallë se z. Kiro Gligorov është i zgjedhur për Kryetar i Republikës Socialiste të Maqedonisë.

³¹ Shih Vendimin për zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit dhe nënkryetarit të Kryetarit të RSM, ('Gazeta zyrtare e RSM' nr.6/91), I sjellur në bazë të amandamentit LXXV të KUShtetutës së RSM-së.

³² Shih Stenogramin e séances së pestë të Kuvendit të RSM i dates 27.01.1991.

Në seancën e njëjtë Kryetari i posa zgjedhur Kiro Gligorov e propozon z. Lupco Gjorgjieski si kandidat për nënkryetar të R.S.M. Në bazë të rrezultateve nga votimi Kryetari i Kuvendit Shpallë se për kandidatin Lupco Gjorgjieski kanë votuar 78 deputetë ndërsa 41 vletëvotime janë të pavlefshme. Në bazë të këtyre rrezultateve Kryetari i Kuvendit shpallë se z. Lupco Gjorgjieski nuk është zgjedhur për nënkryetar të RSM mbasi nuk i fiton 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit dhe nënkryetarit të RSM votimi përsëritet. Në votimin e përsëritur gjithsejt votojnë 118 deputetë prej të cilëve 73 për kandidatin e propozuar ndërsa 45 fletëvotime janë të pavlefshme.

Në seancën e gjashtë të Kuvendit të mbajtur me datë 01.02.1991 Kryetari i RSM Kiro GLigorov e propzon z. Lupco Gjorgjieski për kandidat për nënkryetar të Kryetarit të RSM. Në sajë të votimit konstatohet se votojnë gjithsejt 118 deputet prej të cilëve për kandidatin votojnë 88 deputet ndërsa 30 fletëvotime janë të pavlefshme.

Në bazë të rrezultateve z. Lupco Gjorgjieski zgjidhet për nënkryetar të Kryetarit të RSM³³.

RASTI I II-rë

Në mandatin e parë periodik, në mungesë të mospasjes së shumicës parlamentare të asnjërës parti nuk mundej të formohej qeveria e Maqdonisë. Në anën tjetër, ekzistonin dallime esenciale (në aspekt të shtetformsisë së RM-së) dhe diametralisht qëndrime të kundërta në mes partive të përfaqësuar në Kuvend, veçanërisht në mes partive me më tepër deputet (VMRO-DPMNE-së , LKM- PD, më vonë LSDM, PPD-ja-PDP). Mu për këto rrethana edhe përpos bisedimeve në mes partive u pamundësua formimi i një koalicioni dhe arritja e shumicës për formimin dhe zgjedhjen e qeverisë. Raporti i këtillë objektiv i forcave politike në Kuvend si dhe mosgadishmëria për koalicionim të ndërsjellë solli gati për tre muaj pas konstituimit të kuvendit mos të formohet dhe zgjidhet qeveria.

Në një situatë të zhbërrjes së Federatës Jugosllave dhe rrezikut latent për të shpërthyer një luftë qytetare, gjendja katastrofale ekonomike dhe sociale në një shtet i cili posa kishte filluar procesin e mëvetsisë së tij dhe duke pasur parasysh vlerësimin se në një afat të paparashikueshëm nuk do të mundej të formohet qeveria politike në

³³ shih stenogramin e séances së gjashtë të Kuvendit të RSM të dates 01.02.1991.

këtë konstelacion të partive politike të asaj strukture parlamentare, partitë përfaqësuese në parlament ndërmorrën hap konkret dhe praktik për formimin e një Qeverie të Ekspertëve.³⁴ Padyshim, ky hap praktik për formimin e qeverisë së ekspertëve ishte i pashmangshëm për ti ikur , përkatësisht për t'a menaxhuar krizën parlamentare dhe mos shkohet në zgjedhje të reja.

Mirëpo, këtu duhet theksuar edhe pse u arrit kompromisi, përkrahja nuk ishte e tërësishme nga partitë participuese në parlament, nga fakti se VMRO-DPMNE-ja së cilës pas konstituimit të Kuvendit më 8 Janar të vitit 1991, Kryetari i Republikës ia besoi mandatin për të formuar Qeveri, por ajo nuk arriti të sigurojë shumicën e nevojshme. Kjo parti me numër më të madh të vendeve të fituara në kuvend konsideronte se mosarrtja e marrëveshjes për një koalicion është lojë e partive të bllokut të majtë dhe mosgadishmëria e Kryetarit të Shtetit ta ndajë pushtetin ekzekutiv me partinë e cila ka bindje politike të kundërt. VMRO-DPMNE konsideronte se një Qeveri e tillë në mënyrë të caktuar do të thotë suspendimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe nga këto arsye deputetët e saj ishin të çliruar nga përgjegjësia partiake dhe u ftuan që të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre personale. Pra, kjo parti nuk i dha përkrahje të plotë qeverisë së ekspertëve.

Kriteret për propozimin e kandidatëve për antarë të qeverisë ishin që ato mos jenë antarë të udhëheqësive të ngushta partiake. Vlerësohej se në atë mënyrë do t'i shmanget rrezikut të përcaktimeve ideologjike dhe partiake të ministrave në ndikimin e punës së qeverisë, e që korrespondonte me karakterin e saj si qeveri ekspertësh.³⁵ Debati në lidhje me kandidatët e propozuar dhe zgjedhjen e Qeverisë në esencë paraqet edhe fillimin e kontrollit politik të kuvendit ndaj qeverisë.

³⁴ Në të drejtën kushtetuese krahasimore termini ' qeveri ekspertësh' nuk haset. Kushtetutat e disa vendeve njohin termine tjera. P.sh. Kushtetuta e Bullgarisë (neni 99, alinea 5) parasheh mundësinë që Kryetari i Republikës të emërojë në rast të ndonjë krize parlamentare ' qeverinë zyrtare', në rast kur nuk arrihet pajtueshmëria për formimin e Qeverisë.

³⁵ Në arsyetimin e përbërjes së Qeverisë së ekspertëve theksohej se prej 23 kandidatëve të propozuar vetëm dy deklaruan se janë anëtarë të partive politike (një u deklarua si anëtarë i LKM-së dhe njëri si anëtar i VMRO-DPMNE) . Përndryshe në përbërjen e qeverisë së ekspertëve ishin : tre akademikë, 12 doktorë shkencash, dy magjistra dhe gjatë kuadro të diplomuar me rezultate të dëshmuara në paraktik.

Kjo specifikë e sistemit tonë parlamentar, gjegjësisht vendosjes së relacionit kushtetueso-institucional në mes Kuvendit dhe Qeverisë i jep mundësi Kuvendit me vet faktin e zgjedhjes së Qeverisë të vendos edhe për përbërjen e saj kadrovike. Në rastin e zgjedhjes së Qeverisë së ekspertëve kjo specifikë edhe më tepër erdhi në shprehje ngase asnjë parti politike formalisht nuk qëndronte pas propozimit.³⁶

Në bazë të rezultateve të votimit (prej 115 deputetëve të pranishëm, për zgjedhjen e qeverisë votuan 83, kundër ishin 17 dhe 3 të përmbajtur), Kuvendi i RSM-së në mandatin e saj të parë shumëpartiak, më 21 mars të vitit 1991 e zgjodhi Qeverinë e parë të saj.

Kjo Qeveri karakterizohet si Qeveri me status dhe karakter profesional (ekspertësh), me mosekzistimin e përgjegjësisë politik, të drejtpërdrejtë ndaj ndonjë subjekti konkret politik në Kuvend respektivisht e pavarur partiakisht në punën e saj profesionale.

Të gjitha këto momente në procesin e formimit të qeverisë së ekspertëve patjetër duhej theksuar për tu kuptuar raporti që pas kësaj e kishin partitë politike ndaj punës së qeverisë dhe së fundi edhe çështjen e votëbesimit të qeverisë.

Në këtë periudhë, kjo qeveri funksiononte në kushte jashtëzakonisht të rënda dhe të komplikuar në aspekt të sigurisë politike dhe ekonomike.

Pra, kjo Qeveri politikisht vepronte si e paidentifikuar siç thuhej “ e gjithkujt dhe e askujt ”, aktivitetet e saja pjesërisht ishin të pranuar prej të gjitha partive e pjesërisht të sulmuara dhe të papranuara. Ajo që skishte përkrahje konstante nga shumica në kuvend, në masë të madhe e zvogëlonte fuqinë e dhe energjinë e saj në veprimin e saj qeveritar.

Megjithatë, edhe pse papërcaktueshmëria formalo-politike në paraqitjen e disa antarëve të caktuar të Qeverisë dukshëm shihej veprimi i tyre në suaza të programeve dhe platformave politike të partive të caktuara. Një gjë e tillë gjithmonë e binte në shprehje jounitetin dhe johomogjenitetin në mes antarëve të qeverisë në veprimet dhe

³⁶ Në debat, deputetët e të gjithë grupeve parlamentare I parashtruan mendimet e tyre për kandidatët e propozuar dhe mbersat e tyre për qeverinë. Gjatë saj, akcenti ishte se qeverisë nuk I jepet përkrahje blanko për një besim afatgjatë dhe se zgjidhet si ekip ekspertësh dhe ajo si e tillë edhe duhet të veprojë pa u mbështetur kah cilado qoftë parti politike dhe pa u bazuar në programe partiake.

përcaktimet e tyre në drejtim të shumë çështjeve esenciale për rëndësinë e shtetformësisë së Maqedonisë. Antarë të caktuar para Kuvendit paraqitnin qëndrime krejtësisht të kundërta ose mendime personale nga ato të Qeverisë.³⁷ Jokohezistenca në punën e qeverisë dhe raporti jopërgjegjës i disa antarëve ndaj Kuvendit dhe trupave të tij punues (mospjesmarrja e rregullt në seancat e Kuvendit dhe në komisionet parlamentare, dërgimi jo në kohë i ligjeve dhe mendimeve), reflektohej në efikasitetin e punës së tyre. Kishte vonesë në propozimin e ligjeve organike me çka ngadalsohej operacionalizimi i kushtetutës, nxitej ngadalsim i panevojshëm ose prolongim i seancave të Kuvendit.

Gjendjet e këtilla krijuan një mosbesim të qytetarëve në përgjithsi ndaj punës së Qeverisë, sollën deri te erozioni i autoritetit të saj. E gjithë kjo ishte shkas për ngritjen e mocionit të votbesimit ndaj Qeverisë. Qëndrimi i qeverisë së ekspertëve, tetë muaj pas sjelljes së Kushtetutës së RM-së me të cilën në mënyrë normative u institucionalizuan bazat e sistemit parlamentar të vendit. Duke i marrë parasysh të gjitha vërejtjet e lartshënuara dhe veprimet jokoordinuese të Qeverisë së ekspertëve u imponua nevoja për një identifikim të vërtetë të pozicionimeve politike në Kuvend.³⁸

Kjo qeveri në fakt ishte qeveri partiake ku Kryeministri ishte nga VMRO-DPMNE dhe në punën e saj më tepër udhëhiqej nga një koncept i një politike të unitarizmit nacional maqedonas. Kjo politikë hasi në kundërshtime të partive politike shqiptare dhe bllokut të partive majtiste maqedonense. Kjo kishte për pasojë acarimin e marrëdhënieve ndërnacionale në RM që një gjë e tillë u kurorëzua me sjelljen e Kushtetutës së parë të RM, të cilën nuk e votuan deputetët shqiptarë. Si rezultat i këtij konflikti në Qeveri dhe në parlament të cilën në mënyrë perfide e shfrytëzuan partitë politike maqedone të bllokut të majtë në krye me LSDM-në së bashku me PPD-në

³⁷ Shembull I jounitetit qeveritar është paraqitja e nënkryetarit Bllazhe Ristevski, qëndrimi i së cilit për çështjen e politikës shtetërore ishte ndryshe prej qëndrimit zyrtar të qeverisë; paraqitja e ministrit për marrëdhënie me jashtë Denko Malevski me qëndrim personal për politikën e jashtme përkundrejt qëndrimit të qeverisë.

³⁸ Në mes të 26 nënshkruesve të inicimit të çështje së votbesimit gjendeshin deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare, gjegjësisht parti të përfaqësuara në Kuvend, edhe atë : 15 nga Forcat Reformuese- Partia Liberale, 3 nga LSDM-ja, 2 nga koalicioni PPD-PDP dhe ëshë karakteristike se nuk kishte asnjë deputet nga VMRO-DPMNE, ndërsa nënshkrues ishin edhe 5 deputetë të pavarur.

dhe PDP-në që ti ndalet hovi ekstremizmit maqedonas nga blloku i partive djathtiste maqedone në krye me VMRO-DPMNE-në, në seancën e 44 të Kuvendit të RM-së e mbajtur më 7 korik 1992 u ngrit mosbesim qeverisë së ekspertëve (të Nikolla Kljusevit) i cili votëbesim u aprovua me shumicë votash nga ana e Kuvendit dhe në këtë moment u bë shkarkimi Qeverisë së ekspertëve. Si rezultat i kësaj u formua koalicioni i ri parlamentar në Kuvendin e RM-së, edhe atë në mes LSDM-së, PL-forca reformuese, PS dhe PPD dhe PDP, pra në këtë qeveri partitë politike shqiptare hynë si partner qeveritar ku në krye të Qeverisë ishte Branko Cërvenkoski, lider i LSDM-së.

Ky koalicion parlamentar dhe qeveritar detyrë parësore në programin e tyre kishte relaksimin e marrëdhënieve ndërnacionale në RM-së, decentralizimin e pushtetit qendror të centralizuar apolutisht nga qeveria e Kljusevit në masë shumë të vogël kthimin e kompetencave pushtetit lokal, inkuadrimin e shqiptarëve në institucionet e pushtetit, reforma në sistemin e arsimit me theks të posaçëm popullatë shqiptare, ringjalljen e ekonomisë të trashëguar në mënyrë haotike dhe duke u nisur nga të gjitha këto që u cekën më lartë LSDM në krye me Branko Cërvenkovskin arriti të qendrojë në pushtet deri më 1998.

RASTI I III-të

Mandati i dytë parlamentar³⁹ fillimishtë mbeti pa opozitë parlamentare si pasojë e bojkotimit të rundit të dytë të zgjedhjeve nga dy partitë matë m’dhaja (VMRO-DPMNE-së dhe Partisë Demokratike), të cilat mbeten si opozitë e fuqishme jashata parlamentare. Kualicioni zgjedhorë “Lidhja për Maqedoninë”⁴⁰ në të cilën bënë pjesë LSDM, PL dhe PSM e fituan shumicën parlamentare dhe të drejtën absolute për të formuar Qeverinë. Edhe pse “Bashkimi për Maqedoni” kishte të drejtën absolute për formimin e qeverisë, përsëri hyri në negociata me PPD-në për formimin e qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Kjo ishte si domosdoshmëri e pjesëmarrjes së shqiptarëve në pushtetin ekzekutiv. LSDM-ja si bartëse e kualicionit “Bashkimi për Maqedoninë”, arriti marrëveshje me PPD-në, ku kjo zuri pozicion të volitshëm në

³⁹Ky mandate parlamentar për gati një vit e gjysë funksionoi pa opozitë parlamentare e pastaj u detyrua Partia liberale të dal nga kualicioni qeveritar dhe kaloi në opozitë parlamentare.

⁴⁰ LSDM-ja masë tepërmi i kushtoi rëndësi kualicionimit me PPD-në si parti politike shqiptare ngase ishin presionet e faktorit ndërkombëtar që shqiptarët të përfshihen në Qeveri. PPD-ja mori pjesë me pesë resorë (ministra) ndër to edhe Ministrinë e finansave.

qeveri me pesë resore të ministrive shumë të rëndësishme. Kjo çështje u arrit me një strategji perfide politike nga ana e LSDM-së ngase në parlament mungonte opozita parlamentare dhe përpiqeshte që të krijojë pakënaqësi në partnerin e saj kualicionues zgjedhor-Partinë Liberale. Me formimin e qeverisë, shiheshte qartë se bashkëpunimi i ngushtë në Qeveri ishte në mes, LSDM-së dhe PPD-së. Poashtu, Parlamenti funksiononte në mënyrë shumë të plogësht, ngase mungonte opozita parlamentare. Një gjë të tillë e sulmonte opozita shumë e fuqishme, por jashta parlamentare siç ishte-VMRO-DPMNE dhe Partia Demokratike. Në sajë të saj, pas një viti pune të Parlamentit, për ti ikur kësaj krize parlamentare, Partia Liberale e lëshoi qeverinë dhe lideri⁴¹ i saj e lëshoi postin e kryetarit të Parlamentit dhe kaloi në opozitë reale Parlamentare. Pra kjo ishte një mënyrë e tejkalimit të krizës parlamentare, si rezultat i mungesës së opozitës parlamentare dhe mos funksionimit real të parlamentit dhe qeverisë. Këtu lirisht mund të theksohet se kjo mënyrë e menaxhimit të krizës parlamentare është shumë karakteristike ngase menaxhohet me negociata partiake e jo me instrumente juridiko-politike të garantuara me normativ kushtetuese, gjë që i mungon Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

RASTI I IV-ër

Në mandatin e tretë parlamentar⁴², poashtu është karakteristike për tu theksuar se pati disa momente të cilat sjellshin krizë parlamentare respektivisht qeveritare. Nga rezultati i zgjedhjeve të treta parlamentare, mandatin për formim të qeverisë e mori VMRO-DPMNE e cila zuri më shumë vende në parlament së bashku me Alternativën Demokratike të Vasil Tupurkovskit. Nga partitë politike shqiptare përkatësisht PPD dhe PDSH të cilat ishin në kualicion zgjedhor, më shumë deputet mori PPD-ja dhe sipas kësaj logjike PPD-ja duheshte të jetë pjesë e pushtetit ekzekutiv-Qeverisë. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi dhe me dëshirën dhe qëndrimin e VMRO-së në ekzekutiv u kyq PDSH-ja. Kjo ishte një sinjal që më vonë mund të rezultojë në krizë politike dhe institucionale, mirëpo PPD-ja duke parë rrethanat aktuale jo vetëm në

⁴¹ Me 6.Mars.1996, dha dorëheqje Kryetari i parlamentit Stojan Andov, i cili ishte deputet dhe lider i Partisë Liberale. Zgjedhja e qeverisë me përbërje të re u formua më 23.shkur.1996, ndërsa rekonstruimi i tretë u bë më 20 maj 1997.

⁴² PPD-ja me mashum deputet ngeli jashta Qeverisë.PDSH-ja me 11 deputet mori pjesë në Qeveri ndërsa PPD-ja me 14 deputet mbeti opozitë parlamentare.

Maqedoni por edhe më gjërë në regjion dhe pasojat të cilat politikisht do të mundeshin të komplikojnë politikat e shqiptarëve në regjion u tërhoq dhe mori rolin e opozitës konstruktive në Parlament.

Kualicioni qeveritarë i formuar në mes VMRO-DPMNE-së, Alternativës Demokratike dhe PDSH-së, funksionoi në mënyrë efikase për një vjetë e gjysëm rradhazi dhe pastaj Alternativa Demokratike në mungesë të platformës politike në disharmoni me VMRO-në dhe PDSH-në, arriti të krijojë mosmarrëveshje e cila rezultoi edhe deri te dalja e saj nga kualicioni qeveritarë. Ky ishte një moment ku e humbi logjikën shumica parlamentare dhe u krijua një krizë e thellë jo vetëm parlamentare por edhe politike. Mirëpo VMRO-DPMNE arriti që me një marrëveshje me Partinë Liberale (e cila ishte opozitë parlamentare), dhe PDSH-ja tërhoqi në rradhët e veta një numër të konsiderueshëm të deputetëve të PPD-së dhe arritën të formojnë përsëri shumicë parlamentare në Parlament dhe njëkohësisht krijuan edhe qeveri të re, në këtë mënyrë u tejkalua kriza parlamentare. Pra edhe në këtë rast menaxhimi i krizës parlamentare u arrit përmes marrëveshjeve ndërpartiake, e kjo i ngjanë sistemit parlamentar Italian.

Në këtë mandat parlamentar është shumë e rëndësishme të përmendet edhe konflikti 2001 që rezultoi si rezultat i pakënaqësisë së shqiptarëve me statusin e tyre në koshtetutën e vitit 1991, të cilin status gjithmonë e kontestojshin partitë politike shqiptare në parlament dhe qeveri. Konflikti solli një situatë të re në Republikën e Maqedonisë dhe përsëri e solli Parlamentin dhe Qeverinë në një bllokadë totale të funksionimit të tyre. Me ndërhyrjen e faktori ndërkombëtar relevant (BE dhe SHBA), dhe me ndërprerjen e konfliktit u imponua nevoja e krijimit të strukturës parlamentare pa opozitë dhe kyqjen e partive politike më relevante maqedone dhe shqiptare (VMRO-DPMNE, LSDM, PPD dhe PDSH), ku njëkohësisht u formua edhe qeveria e shpëtimit kombëtar e cila kishte për detyrë parësore që të arrije marrëveshjen pas ndërprerjes së konfliktit (Marrëveshja Kornizë e Ohrit). Pra kjo mënyrë e menaxhimit të krizës së thellë politike dhe institucionale u menaxhua me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar.

RASTI I V-të

Në dhjetor të vitit 2016, kur u zhvilluan zgjedhjet parlamentare pas dorëheqjes së kryeministrit Gruevski, në Maqedonia pothuajse ngeli pa qeveri. Asnjë prej dy partive të mëdha VRMO-DPMNE (51 deputetë) dhe LSDM (49 deputetë) nuk arritën të fitonin shumicën e nevojshme prej 61 deputetësh për të formuar qeverinë. Partitë shqiptare, me në total 20 deputetë u bënë vendimtare për formimin e qeverisë së re. Bisedimet mes VRMO-DPMNE dhe BDI-së dështuan. Përpara se të nisnin bisedimet për koalicion me Zoran Zaev të LSDM-së, liderët e partive shqiptare u mbledhën në Tiranë, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe miratuan një marrëveshje që unifikoje qëndrimin e tyre për statusin e shqiptarëve në Maqedoni. Pikërisht kjo marrëveshje e nënshkruar në Tiranë, u bë shkak që Presidenti Ivanov i mohoi dy herë radhazi të drejtën për formimin e qeverisë Zoran Zaev, i cili arriti të bashkohet me partitë shqiptare dhe të mbledhë 67 deputetë. Presidenti Ivanov, në refuzim të koalicionit të Zaev, u shpreh se: “kushtetuta dhe ndërgjegjia ime më ndalon të jap një mandat për këdo që shkatërron sovranitetin dhe integritetin e Maqedonisë.” Ai shtoi se Zoran Zaev duhet të jetë i pari që të refuzojë një “platformë që vjen nga një vend i huaj”.

Presioni perëndimor rritej gjithnjë e më shumë mbi Maqedoninë për të formuar institucionet dhe për t'i dhënë fund krizës, BDI-ja dhe Aleanca për shqiptarët dhe LSDM-ja vendosën që të vijojnë procedurat për të anashkaluar presidentin Ivanov dhe për të vazhduar me krijimin e Kuvendit si dhe për herë të parë në Maqedoni, kryetari i Kuvendit do të jetë shqiptar, i cili do të dalë nga radhët e BDI-së. Pas zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, Kuvendi i R Maqedonis me 1. korik 2017 e zgjodhe edhe Qeverinë e re Reformatore të Zoran Zaevit si Qeveri e koalicionit LSDM, BDI dhe ASH.

Duhet theksuar se rol vendimtarë në zgjedhjen e kësaj krize politike dhe institucionale më serioze nga pamvarsimi i Maqedonisë ka pasur faktori ndërkombëtar edhe atë SHBA-të dhe BE-ja.

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

I. Krizat parlamentare si procese politike legjitime janë pjesë e luftes politike parlamentare të opozitës për të kontrolluar qeverinë dhe imponuar zgjedhje e parakohëshme. Autori konkludon se krizat parlamentare në rastet më të shpeshta paraqiten si rezultat i strategjisë opozitare dhe përpjekjeve të opozitës për ta kthituar dhe rëzuar qeverinë në rrugën parlamentare.

II. Krizat parlamentare janë pjesë e demokracisë së një vendi dhe reflektim i drejtpërdrejtë i sistemi kushtetues dhe qeverisës, pluralizmit politik dhe stabilitetit të përgjithshëm politik. Fenomeni i krizave parlamentare është tipik për demokracitë e reja dhe shtetet e tranzicionit postkomunistë, të cilat në fazën e transformimeve demokratike po ndeshen me shumë kundërthënie politike dhe me një pluralizëm të shkapërderdhur që reflekton një skenë politike të paprofilizuar dhe me qeverisje jo stabile. Në anenë tjetër demokracitë e stabilizuara fenomenin e krizave politike e marrin kryesisht si reflektim ekskluziv të veprimit të opozitës parlamentare. Në këto shtete pluralizmi politik është i stabilizuar dhe nuk mund të ketë situata të papritura politike. Përparësitë që ofron demokracia mazhoritare dhe sistemi dypartiak në raport me krizat parlamentare krijon sisteme demokratike stabile dhe të qëndrueshme pa kriza evidente politike dhe parlamentare.. Në faktë, krizat parlamentare në këto shtete gati janë të pamundëshëm sepse ekziston një demokraci e pastër mazhoritare, ku fituese fiton të gjitha në raport me qeverinë, kurse humbësi kalon në opozitë, ku konsolidohet dhe me një strategji opozitare rikthehet në pushtet.

III. Menaxhimi i krizave parlamentare paraqet pjesë të jetës politike dhe demokratike dhe kushtetuese. Veçoria e demokracisë konsiston në faktin , se ajo parasheh instrumentet adekuate të mbrojtjes së saj na anarkia, diktatura dhe dhuna. Menaxhimi i krizave parlamentare kryesisht bëhet në dy rrugë demokratike; me negociata politike, kompromise dhe marrëveshje me të cilën subjektet e jetës politike merren vesh për zgjidhjen e situatave konfliktoze dhe rivendosin parlamentarizmin në rrjedha normale. Rruga e dytë, kur mungon vullneti politik për zgjidhjen e konflikteve me marrëveshje, konsiston në përdorimin e mekanizmave kushtetuese me të cilat ripërtrohet jeta parlamentare dhe demokratike, duke evituar

kaosin dhe dhunen nga skena politike. Instrumentet kushtetuese në rastë të dështimit politik në zgjidhjen e krizave parlamentare bëjnë menaxhimin kushtetues të krizës dhe rivendosin balansin e nevojshëm kushtetues për funksionimin e shtetit dhe ruajtjen e demokracisë. Tejkalimi i shpejtë dhe efikas i një krize parlamentare ndikon në stabilitetin e përgjithshëm politik dhe eviton edhe krizat e natyrave të tjera, përfshirë këtu edhe konfliktet politike, dhunen, madje edhe luftën civile.

IV. Në shtetet e transicionit demokratik, krizat parlamentare janë pjesë e jetës parlamentare, kryesisht si rezultat i një pluralizmi të pakontrolluar dhe të paprofilizuar, i cili nuk krijon një qeveri stabile dhe opozitë të fortë parlamentare. Në këto shtete pas aplikimit të pluralizmit politik u trashigua edhe një bagazh i së kaluarës komuniste, i cili konsiston në luftën për pushtet dhe mungesën e një sistemi të qeverisjes së mirë. Këto demokraci të reja në rrugën drejtë tranzicionit dhe integriteteve evropiajane cilësohen me koalicionet qeveritare, të cilat shpeshë nuk janë programore, të qëndrueshme dhe efikase. Qeveritë në këto shtete, jo rrellë programet e tyre partijake i shendrojnë në programe qeveritare dhe nuk kanë aftësi të instalojnë një qeverisje efikase dhe shtetërore. Në anaën tjetër edhe opozita parlamentare në këto shtet nuk është aktive në ushtrimin e rolit të saj jo vetëm kritik, por edhe alternativ që i shquan opozitat me traditë demokratike.

V. Republika e Maqedonisë në periudhën e transicionit të saj, ka arritë të krijoj përvojat e para parlamentare në formë të një republike parlamentare me një sistem pluralistë politik, në të cilin vepron një pjesë e madhe e partive politike, përfshirë këtu edhe partitë politike shqiptare. Parlamentarizmi në Maqedoni po manifeston tiparet tipike për shtetet e Evropës Juglindore. Edhe këtu janë paraqitur disa raste të krizave parlamentare, kryesisht për shkak të dështimit të koalicioneve qeveritare, votimit të mocionit të mosbesimit të qeverisë dhe dorëheqjes së Kryeministrit. Sa i përket opozitës parlamentare në Maqedoni, ajo vepron nd dy rrafshe: si opozitë parlamentare dhe si opozitë brenda partive etnike. Kështu brenda bllokut maqedon ekziston opozita e një partie të dytë maqedone, njësoj sikur edhe te partitë politike shqiptare, ku njera prej tyre participon në qeveri, kurse tjetra kalon në opozitë. Ky fenomen që është tipik për Maqedonin ka rezultuar me një tension tek partitë politike shqiptare, që ka ardhë në shprehje sidomos në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Literatura

- Elezi, Z., 2015. **Constitutional agreement basic to functioning of multiethnic states.** Craiova, Romania, The Center of Post-Communist Political Studies (CEPOS).;
- Elezi, Z., 2015. **The context of democratic transition in Macedonia.** Craiova, Romania, The Center of Post-Communist Political Studies (CEPOS).;
- Elezi, Z., 2015. **FUNDAMENTAL PRINCIPLES OF DRAFTING THE CONSTITUTION** Speaker: Assoc.Prof. Zemri Elezi, South East European University, FYR of Macedonia. Albena, Bulgaria,;
- Bajrami, Arsim, *Demokracia parlamentare*, Prishtinë, 2005
- Bajrami, Arsim., *Teoria dhe Praktika Parlamentare*, botim i Fakultetit Juridik, Prishtinë, 1997.
- .Bajrami, Arsim., *Kosova-political, international law and constitutional argumentes* , koautor me Dr. E. Stavilecin dhe Mr. B. Reken, Prishtinë, 1996.
- Bibic, A. *Politicka znanost*, Zagreb, 1971.
- Burdeau, Geoges, *Droit Constitutional et institutions politiques*, Paris, 1980.
- Dhimo, Dh., *E drejta kushtetuese e Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë, 1963.
- Fira, A., *Ustavno pravo*, Beograd, 1984.
- Omari, L., *Sistemi parlamentar*, botoi “Elena Gjika”, Tiranë 1994.
- Omari, L., *Parimet dhe institucionet e së drejtës publike*, Tiranë, 1993.
- Oamani, Ismail, *Fillet e së drejtës*, Prishtinë, 2004,
- Salju, Kurtesh, *E drejta Kushtetuese*, libri I, Prishtinë 2004
- Pasic, N., *Uporedni politicki sistem*, Beograd, 1976.
- Lukic, N., *Uvod u pravo*, Beograd, 1986.
- Stefanovic, J., *Ustavno pravo*, Zagreb, 1963.
- Sokol, S., *Ustavno pravo i politicke institucije*, Zagreb, 1991.
- Stavileci, E., *Kosova dhe shqiptarët*, Prishtinë, 1991.
- . Zajmi, G., *Dimensionis oh the Question of Kosva in the ballkans*, Prishtinë, 1994.
- Gjorgjeviq, J., *E drejta kushtetuese*, Prishtinë, 1991.
- Krenar Laloçi, *E drejta kushtetuese*, Tiranë, 1997.
- Shkariq. Svetomir, *Ustavno pravo I II Shkup*, 2002
- Brajanovski, Bllagoja, *Parlamentarizmot-modeli i iskustva*, Shkup, 1999,

- Milosavlevski, Slavle, Demokratski kontraverzi vo makedonski plurarizam 1990-2002, Shkup
- Duhamel, Oliver, E drejta kushtetuese dhe demokracia, Shkup, 2004
- Kitaniovski.Llazar, Podelba na vlasti. Shkup 2000.
- Klimovski, Savo, Ustavno pravo i politicki institucije, Shkup, 2002.
- Aziri, Etem, Partitëpolitike dhe demokracia, Tetovë, 2003
- Antras Sajo, *Limiting Government*, CEU-Central European University Press, Budapest, 1999 , fq.104-193).
- Arrow, K. J. Social Choices and Individual Values, 2nd edition, Yale U.P.1977
- Bonner, John Politics, Economics and Welfare, Wheatsheaf 1986
- Brennan, G. Politics and Process: New Essays in Democratic Thought, CUP & Lomasky, L. E. (ed), 1989
- Craven, J. Social Choice, CUP 1992
- Elster, J. Foundations of Social Choice Theory, Cambridge U.P. 1986. & Hylland, A.(eds)
- Heap, S.H. et al The Theory of Choice: A Critical Guide, Blackwell 1992
- McLean, I. Public Choice, Blackwell 1987
- Mueller, D.C. Public Choice II, CUP 1989
- Sen, Amartya Choice, Welfare and Measurement, Blackwell 1982
- Black, D. The Theory of Committees and Elections, CUP 1958
- Dodgson, C.L. 'A Discussion of the Various Methods of Procedure in Conducting Elections', reprinted in D. Black, The Theory of Committees and Elections, CUP 1958

Akte ligjore dhe kushtetuese

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonis
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e SHBA-ve
- Kushtetuta e Republikës së Kroacisë
- Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë
- Kushtetuta e IRJ të Maqedonisë
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Francës
- Ligji Themelor i Gjermanisë

- Kushtetuta e Italisë
- Kushtetuta e Bullgarisë
- Kushtetuta Rumanisë
- Kushtetuta e Hungarisë
- Kushtetutat e vendeve të tjera

Faqet elektronike

[http: www.unmikonline.org](http://www.unmikonline.org)

[http: www.kosova.com](http://www.kosova.com)

<http://www.bbc.co.uk/albanian/>

<http://www.balkanweb.com/>

<http://www.voanews.com/albanian/>

<http://www.mid.ru/>

<http://www.rian.ru/>

<http://www.mfa.gov.al/>

www.crisisgroup.org

www.crisisweb.org